| 11 | 09450. | 02 | Aparati i Ministrisë                                      | GM11024 | Projekte te huaja (230)  |        | 4,411  |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti "L.Gurakuqi", Shkoder                        | GM11053 | FINAC Univ. Shkoder (230)  |        | 1,774  |
| 11 | 09450. | 02 | Aparati i Ministrisë                                      | GM11059 | Projekte te huaja  |        | 154    |
| 11 | 09450. | 02 | Aparati i Ministrisë                                      | GM11063 | Projekte te huaja  |        | 1,918  |
| 11 | 09450. | 02 | Aparati i Ministrisë                                      | GM11064 | Projekte te huaja  |        | 675    |
| 11 | 09450. | 02 | Aparati i Ministrisë                                      | GM11065 | Projekte te huaja (Aparati)  |        | 945    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                           | GM11032 | Zhvillimi i Planprogrameve mesimore per masterin e perbashket Shkenca Politike Europiane (euro PS)   |        | 3      |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                           | GM11033 | Fuqizimi i potencialit kerkimor te IAL duke kontribuar ne zhvillimin e Rajonit te Ballkanit Perendimor-Re@EBC (230)                              |        | 374    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                           | GM11045 | Project EM2-STEM, ELISSA EUROÉEB   |        | 135    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                           | GM11033 | Fuqizimi i potencialit kerkimor te IAL duke kontribuar ne zhvillimin e Rajonit te Ballkanit Perendimor-Re@EBC                                    |        | 2,359  |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11037 | TEMPUS "lifelong Learning for Sustainable Agroiculture in the Albs Danube Adriatik Region Life ADA   |        | 69     |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11038 | IPA "Adriatik holistik Forest Fire protection"   |        | 265    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11039 | Enhancing of legume groëing in europe through sustainablecropping for protein supply for food anf feed   |        |        |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11040 | Tempus Reneëable Energy studian in Eëstern Balkan Countries (RESI)   |        |        |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11041 | IPA "Adriatik Food and Tourizm innovating smes"  |        | 418    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11042 | ERASMUS + "LIBRARY NETÉORK SUPPORT SERVICES (LNSS) (230)   |        | 316    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11047 | IPA DeFishGear UBT   |        |        |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11051 | ERASMUS+CBHT UBT   |        |        |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11052 | ERASMUS+NETCHEM UBT (230)  |        | 476    |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11043 | IPA "Adriatik Model Forest"  |        |        |
| 11 | 09450. | 02 | Universitetet shqetorore                                  | GM11046 | Projekte te huaja (230)  |        | 1      |
| 11 | 09450. | 02 | Universitetet shqetorore                                  | GM11046 | Projekte te huaja (230)  |        | 1      |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Bujqesor i Tiranës                           | GM11052 | ERASMUS+NETCHEM UBT  |        | 1,661  |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti "Aleksander Moisiu" Durres                   | GM11061 | Projekte te huaja (230)  |        | 1,868  |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti "Aleksander Moisiu" Durres                   | GM11062 | Projekte te huaja  |        | 1,026  |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti i Tiranës                                    | GM11066 | Projekte te huaja (230)  |        | 2      |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11067 | Projekte te huaja (230)  |        | 7      |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11068 | Projekte te huaja (230)  |        | 1,682  |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11068 | Projekte te huaja (231)  |        | 1,848  |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11069 | Projekte te huaja (230) U Elbasan  |        | 2,265  |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11070 | Projekte te huaja (230) U Elbasan  |        | 6      |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11071 | Projekte te huaja (230) U Elbasan  |        | 599    |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11072 | Projekte te huaja (230) U Elbasan  |        | 9      |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                           | GM11073 | Projekte te huaja (230) UPT  |        | 1,576  |
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11074 | Projekte te huaja (230)  |        | 212    |

|    |        |    |   |         |   |         |  |         |
|----|--------|----|---|---------|---|---------|--|---------|
| 11 | 09450. | 02 | 1011043   | GM11075 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 1       |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti i Sporteve, Tirane                               | GM11076 | Projekte te huaja (230) U GJ  |         |  | 1,850   |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti i Arteve Tirane                                  | GM11077 | Projekte te huaja (231)   |         |  |         |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti i Arteve Tirane                                  | GM11077 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 1       |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti i Arteve Tirane                                  | GM11078 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 330     |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11079 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 4       |
| 11 | 09450. | 02 |   | GM11080 | Projekte te huaja (230) UT  |         |  | 376     |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti "L.Gurakuqi", Shkoder                            | GM11081 | Projekte te huaja (230) USH   |         |  | 1       |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11082 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 1,119   |
| 11 | 09450. | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11083 | Projekte te huaja (230)   |         |  | 260     |
| 11 | 09450. | 02 | Qendra e Sherbimeve te Rrjetit Telematik Akademik, Tirane     | GM11001 | Bashkepunimi me Italine (230)   |         |  | 10,507  |
| 11 | 09450. | 02 | Qendra e Sherbimeve te Rrjetit Telematik Akademik, Tirane     | GM11001 | Bashkepunimi me Italine (231)   | 150,000 |  | 103,216 |
| 11 | 09770  | 02 | Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit Tirane | GM11035 | Projekte te kerkimit shkencor   | 30,000  |  | -       |
| 11 | 09770  | 02 | Aparati i Ministrisë  | GM11031 | Permisimi i mbrojtjes dhe mireqenies se femijve ne Europe                                   |         |  | 960     |
| 11 | 09770  | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11027 | Projekti Rrjeti i Adriatikut bazuar ne Integrimin e Sistemeve te Radareve dhe platforma Eëb |         |  | 0       |
| 11 | 09770  | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11029 | Goeëeb-Erasmus+   |         |  | 794     |
| 11 | 09770  | 02 | Universiteti Politeknik, Tiranë                               | GM11030 | H2020-Vission   |         |  | 292     |

## **Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12- mujorin 2018:**

1. **Vonesa në shpalljen e thirrjeve dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për fondet e zhvillimit e rajoneve 2018**, për projektet e reja për vitin 2018, Vendimi i Komitetit për Zhvillimit e Rajoneve Nr.7 datë 11.5. 2018 në shumën prej 1.5 miliard lekë për projektet e reja për vitin 2018.
2. **Moszbatimi i grafikut të punimeve për objektet/kontratat nga autoriteti kontraktor** në vijim nga viti 2017-2018, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kontraktorët e punimeve për 8-mujorin e parë Janar-Gusht 2018.
3. **Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2018**, si dhe lidhja e kontratave është realizuara 12-mujorin e parë 2018, me ndikim dhe risk të lartë në realizimin e fondeve për vitin 2018.

Në formë analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizmi i fondeve të buxhetit sipas objektivave, produkteve dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën 12- mujore 2018, paraqitet sa vijon;

## **I – Programi buxhetor PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 01110);**

### **Objektivat kryesore:**

**Objektiv 1).** Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese me 15-17% të punonjësve në MAS, njësite arsimore vendore dhe institucioneve arsimore për 100-120 punonjës.

**Objektiv 2).** Krijimin e një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore , përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore, për implementimin e planeve strategjike të arsimit me synim përdorimin me eficensë dhe efektivitetin në punë të burimeve njerëzore, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës, rinovimit të pajisjeve e aktiveve të qëndrueshme me 10% në vit, pajisjeve të zyrave, pajisje teknologjike, rikonstruksionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese.

**Objektiv 3).** Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.

**Objektiv 4).** Auditimi i 30% dhe inspektimi në 10-12% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.

**Objektiv 5).** Trajnimi çdo vit për 100 drejtuesve të institucioneve arsimore për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

## **Fondet e shpenzime korrente sipas planit 2018 janë 797 milion lekë;**

a) **Fondet për shpenzime personeli për vitin 2018, në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”**, arrijnë nga 601.3 milion lekë, fondet e rishikuara për vitin 2018 arriten në shumën 545.3 milion lekë ose 75.7% e fonde të rishikuara për këtë program.

Realizimi për periudhën 12-mujore është në masën 497 milion lekë ose në 91.1% ndaj fondit të planifikuar për periudhën 12-mujore 2018.

**Fondet për shpenzime personeli për vitin 2018 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore për 662 punonjës nga të cilët;**

- 1) Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për 134 punonjës (pas ndryshimeve të strukturën e miratuar/ ndryshuar për vitin 2018, ky numër është **134 punonjës**)
- 2) Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me 270 punonjës e specialistë
- 3) Zyrat Arsimore në Rrethe, 25 zyra me 238 punonjës e specialistë;
- 4) Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, për 28 punonjës (pas ndryshimeve të strukturës e miratuar për 2018)

b) **Fonde për krijimin e kushteve të punës** për rreth 664 punonjës në Aparatin e MASR si dhe DAR/ZA dhe Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, për vitin 2018 janë planifikuar **123.7 milion lekë** në vit ose 17.3% e fondeve të miratuara për këtë program. Buxheti i rishikuar pas akteve normative 2018 fondet për shpenzime korrentë janë **në masën 142 milion**, ku sipas përparësive janë parashikuar; fonde për të mbuluar shpenzimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale të tjera zyre.

Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MASR, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj.

**Realizimi për periudhën 12-mujore në masën 130.8 milion lekë ose në masën 92%**, ndaj fondit të planifikuar për periudhën 12-mujore 2018.

c) **Fondet për shpenzime kapitale** për vitin 2018 janë **72 milion lekë**, ose 9% e fondeve të këtij programi. Synim kryesor është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës me qëllim përmirësimin e kushteve të punonjësve në 40 institucione arsimore ku përfshihen 38 DAR ZA, Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, si dhe Aparati i MASR.

Burimi financimit është 100% nga buxheti i shtetit, për vitin 2018 në këtë program për shpenzime kapitale ishte në masën 72 milion lekë.

**Fondi i rishikuar për vitin 2018 është 55.7 milion lekë, realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 12-mujore është në masën 35.6 milion lekë ose në 64%** ndaj fondit të planifikuar për periudhën 12-mujore 2018.

**Sipas projekteve kryesore paraqiten:**

- a) **Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese** në 5 objekte me vlerë të plotë të projekteve 29.4 milion lekë, në DAR Kukës , ZA Sarandë, ZA Devoll, ZA Kuçove si dhe DAR Qarku Tiranë në shumën 29.1 milion lekë janë realizuar vetëm 27.7 milion lekë, (nuk është realizuar kontrata vetëm në ZA Devoll).
- b) **Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike** për shërbimet në MASR, DAR/ZA, në shumën 1.5 milion lekë, janë realizuar vetëm 1.49 mijë lekë, përshkak se fonde kanë qënë të ngrira nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.
- c) **Blerja e pajisjeve e mobileri zyre** për krijimin e kushteve të punës në MASR, në shumën 1.9 milion lekë, realizimi nga kompania zbatuese është në masën 0.4 milion lekë.
- d) **Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike** dhe videokonferenca për shërbimet në MASR, DAR/ZA, në shumën 15.3 milion lekë, këto fonde nuk janë realizuar, përshkak se fonde kanë qënë të ngrira nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

**Për vitin 2018 fondi i rishikuar në programin 01110 është 55.7 milion lekë, realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 12-mujore është në masën 35.6 milion lekë ose në 64%** ndaj fondit të planifikuar për periudhën 12-mujore 2018

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018**, në këtë program është në MASR në masën **89%** dhe përfaqëson rreth 1.8% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë për periudhën 12- mujore 2018, sipas zërave kryesore.


|   |            |
|---|------------|
| Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korrentë  | <b>91%</b> |
| Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale | <b>64%</b> |
| <b>Gjithsej</b>                                       | <b>89%</b> |

**Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12-mujorin vitin 2018;**

1. Shpenzimet e personelit nuk janë realizuar pasi nuk është plotësuar numri i miratuar i punonjësve sipas strukturave të miratuara për vitin 2018, rreth 124 vende/pozione pune nuk janë plotësuar, megjithëse janë zhvilluar procedura nga DAP.
2. Nuk janë realizuar me sukses procedurat e punësimit dhe plotësimi i numrit të punonjësve të miratuar për Aparatin e MASR si dhe DAR ZA-ve konform ligjit të shërbimit civil e për këtë arsye nuk janë realizuar shpenzimet e personelit.
3. Nuk janë realizuara fondet e miratuara për rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne DAR/ZA në 5 objekte.
4. Nuk janë realizuara fondet e miratuara për blerje pajisje elektronike, fondet janë mbajtur të ngrira ga MFE
5. Nuk janë realizuara fondet e miratuara për trajnimin e personelit si dhe drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, janë duke u realizuar me fonde nga donatorëve pranë Institutit të Zhvillimit të Arsimit Tiranë.

**Tabela nr. 1(01110 PM)** Fondet e realizuara në vitin 201-2017, fondet e planifikuara PBA 2018, fondet e miratuara në ligjin vjetor 2018, fondet e rishikuara për vitin 2018, si dhe fondet e realizuara për vitin 2018 në 000 lekë dhe në %.

| ANEKSI Nr.2   |                                       |   |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
|---|---------------------------------------|---|---------------------|------------------|------------------|------------------------|---------------------------------|---------------------|-----------------|---------------------------|
| Tabela 5: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve per Buxhetin 2018 (cdo 4 mujor progresive) |                                       |   |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
|   |                                       | ne 000 leke                             |                     |                  |                  | 12 mujori 2018         |                                 | ne 000 leke         |                 |                           |
| Ministria   |                                       | MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 | Kodi                      |
| Programi  |                                       | Planifikim Menaxhim                     |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 | Titulli                   |
|   |                                       | Totali Shpenzimeve                      |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
| Artikulli   |                                       | 0                                       | 1                   | 2                | 3                | 4                      | 5                               | 6                   | (7)=(6)-(5)     | Realizim ne %             |
| Kodi  | Emri                                  | Fakti 12-mujor 2016                     | Fakti 12 mujor 2017 | PBA 2018         | Buxheti 2018     | Buxheti rishikuar 2018 | Buxheti perndihes 12 mujor 2018 | Fakti 12 mujor 2018 | Diferenca 2018  | ndaj planit 12-mujor 2018 |
| 600   | Paga                                  | 409,667.0                               | 425,160.4           | 456,850.0        | 506,850.0        | 450,868.5              | 450,868.5                       | 426,048.7           | 24,819.8        | 94%                       |
| 601   | Sigurime Shoqërore                    | 66,992.0                                | 69,554.5            | 84,450.0         | 94,450.0         | 94,450.0               | 94,450.0                        | 70,930.9            | 23,519.1        | 75%                       |
| 602   | Mallra dhe Shërbime të Tjera          | 139,773.5                               | 114,513.7           | 123,342.0        | 123,342.0        | 136,009.7              | 136,009.7                       | 124,474.3           | 11,535.4        | 92%                       |
| 603   | Subvencione                           |   |                     | 0.0              | 0.0              | 0.0                    | 0.0                             | 0.0                 | 0.0             |                           |
| 604   | Transferata Korente të Brendshme      |   |                     | 0.0              | 0.0              | 0.0                    | 0.0                             | 0.0                 | 0.0             |                           |
| 605   | Transferata Korente të Huaja          | 419.1                                   | 411.9               | 0.0              | 0.0              | 420.0                  | 420.0                           | 389.1               | 30.9            | 93%                       |
| 606   | Trans per Buxh. Fam. & Individ        | 1,355.9                                 | 2,689.9             | 400.0            | 400.0            | 5,977.5                | 5,977.5                         | 5,918.1             | 59.4            | 99%                       |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Korrente</b>             | <b>618,207.4</b>                        | <b>612,330.4</b>    | <b>665,042.0</b> | <b>725,042.0</b> | <b>687,725.7</b>       | <b>687,725.7</b>                | <b>627,761.7</b>    | <b>59,964.6</b> | <b>91%</b>                |
| 230   | Kapitale të Patrupezuara              | 0.0                                     | 0.0                 | 0.0              | 0.0              | 0.0                    | 0.0                             | 0.0                 | 0.0             |                           |
| 231   | Kapitale të Trupezuara                | 127,506.5                               | 45,315.5            | 52,000.0         | 72,000.0         | 55,682.0               | 55,682.0                        | 35,651.6            | 20,030.4        | 64%                       |
| 232   | Transferata kapitale                  | 0.0                                     |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Kapitale fin Brendsh</b> | <b>127,506.5</b>                        | <b>45,315.5</b>     | <b>52,000.0</b>  | <b>72,000.0</b>  | <b>55,682.0</b>        | <b>55,682.0</b>                 | <b>35,651.6</b>     | <b>20,030.4</b> | <b>64%</b>                |
| 230   | Kapitale të Patrupezuara              |   |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
| 231   | Kapitale të Trupezuara                |   |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
| 232   | Transferata kapitale                  |   |                     |                  |                  |                        |                                 |                     |                 |                           |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Kapitale fin Huaj</b>    | <b>0.0</b>                              | <b>0.0</b>          | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>             | <b>0.0</b>                      | <b>0.0</b>          | <b>0.0</b>      |                           |
| <b>Totali</b>   | <b>Korrente dhe Kapitale</b>          | <b>745,713.9</b>                        | <b>657,645.9</b>    | <b>717,042.0</b> | <b>797,042.0</b> | <b>743,407.7</b>       | <b>743,407.7</b>                | <b>663,412.7</b>    | <b>79,995.0</b> | <b>89%</b>                |
| <b>Jashte Buxhetore</b>   |                                       | <b>10,882.7</b>                         | <b>4,515.5</b>      | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>       | <b>2,338.2</b>         | <b>2,338.2</b>                  | <b>2,338.2</b>      | <b>0.0</b>      | <b>0%</b>                 |
| <b>Totali (korrente + kapitale + jashte buxhe)</b>  |                                       | <b>756,596.6</b>                        | <b>662,161.4</b>    | <b>717,042.0</b> | <b>797,042.0</b> | <b>745,745.9</b>       | <b>745,745.9</b>                | <b>665,750.8</b>    | <b>79,995.0</b> | <b>89%</b>                |
|   | Ndaj PBB ne %                         | 0.05%                                   | 0.04%               | 0.04%            | 0.05%            | 0.05%                  | 0.05%                           | 0.04%               | 0.00%           |                           |
|   | Shpenzimet Totale te konsoliduar      | 0.17%                                   | 0.14%               | 0.14%            | 0.16%            | 0.15%                  | 0.15%                           | 0.13%               | 0.02%           |                           |





**Gjatë kësaj vitit 2018 në MASR,** është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe implementimin e reformës në arsim dhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për “Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2018”;

1. Janë propozuar për miratim në KM, për ndryshime në **2 akte ligjore dhe janë miratuar proceduar** për miratim në KM projekt-ligji për Rininë, si dhe projekt-ligji për disa ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për arsimin parauniversitar në RSH”, i miratuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin **ligjin nr. 48/2018**“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
2. Janë hartuar dhe propozuar për miratim në KM, rreth 58 projektvendime, për ndryshime në akte nënligjore dhe janë miratuar në KM **51 (njëzetë e një) vendime** të Këshillit të Ministrave.
3. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR, **40 udhëzime të Ministrit** të Arsimit Sportit dhe Rinisë, si dhe Udhëzime të Përbashkëta me Ministrinë të Linjës
4. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR, **823 urdhra të Ministrit** të Arsimit Sportit dhe Rinisë.
5. Gjatë vitit 2018, janë realizuar **38 raporte monitorimi për institucionet publike** dhe private të arsimit të lartë “Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion”.
6. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), së bashku me një agjenci britanike anëtare e ENQAS gjatë vitit 2017-2018 **ka përfunduar akreditimin institucional në 37 IAL-ve** dhe së bashku me vlerësimin e realizuara në vitin 2018 janë realizuar 35 vlerësime institucionale.
7. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë vitit 2018 ka realizuar akreditim të 67 programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë.  
Këto vlerësime janë të botuara në faqen zyrtare të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).  
<https://ëëë.ascal.al/sq/informacione/raportet-e-akreditimit-qaq>.

#### **Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për vitin 2018 ka realizuar detyra si më poshtë vijon;**

1. Detajimi, ndjekja e zbatimit të fondeve të buxhetit, miratuar me ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”,
    - a. Detajimi i të fondeve të buxhetit për të gjitha institucionet e sistemit të MASR, për vitin 2018;
    - b. Detajimi i shpenzimeve mujore të fondeve për të gjitha institucionet e sistemit të MASR, për vitin 2018;
  2. Hartimi i planit të shpenzimeve në valutë për institucionet arsimore për vitin 2018;
  3. Hartimi dhe shpërndarja e fondeve të buxhetit për institucionet e sistemit të MASR, për periudhën afatmesme 2018-2020;
  4. Hartimi dhe shpërndarja e fondeve për investimet për institucionet e sistemit të MASR, për periudhën afatmesme 2018-2020
  5. Përgatitja e raportit të konsoliduar të monitorimi të zbatimit të buxhetit për vitin 2017, së bashku me anekset e monitorimit (aneksi 13-të) për vitin 2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 12 mujor Janar – Dhjetor 2017;
  6. Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2017, dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
  7. Hartimi i planit të shpenzimeve investime në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve për vitin 2018 për institucionet arsimore (Sekretaria teknike) dhe dërgimi në Këshillin e Ministrave;
  8. Raportime në Ministrinë e Financave për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi për vitin 2018, si dhe borxhet e mbartuara nga viti 2017, 3-mujorin e parë, 6-mujorin 2017, 9-mujor dhe vjetor për vitin 2018;
  9. Raportime në Ministrinë e Financave për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi nga zbatimi i vendimet gjyqësore të formës së prerë të likuidura me fonde buxhetore për periudhën 2015-2016-2017-2018.
  10. Raportime në Ministrinë e Financave për shpenzimet në valutë për institucionet arsimore, për vitin 2017, për 4-mujorin e parë, 8-mujorin 2018 dhe vjetor 2018
  11. Analizë dhe përgatitje e shkresave/autorizimeve për nëpunësin autorizues si dhe nëpunës zbatues të institucioneve arsimore;
  12. Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për udhëtime e dieta të punonjësve të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
  13. Analizë dhe përgatitje e autorizimeve për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
  14. Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2019-2021, mbështetja nga Sektorit të Buxhetit në Ekipet e Menaxhimit të Programeve në MASR, sipas tavanëve buxhetore të miratuara me endimin nr.128, datë 07.3.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”.
- **Faza e Parë**, shkresa nr.3151/1 , date 03.05.2018 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Vendimin nr.462, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”.
  - **Faza e Dytë**, shkresa nr.8406/1 , date 01.09.2018 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, shkresa nr.8406/2, date 19.9.2018 dërguar në Ministria Financës Ekonomisë në lidhje me kërkesat shtesë si dhe prioritete e PBA 2019-2021.  
Vendimin nr.462, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”.

15. Pjesmarrja në grupe pune për hartimi i projekt akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar dhe uni versitar në tërësi dhe për pjesën financiare në veçanti, konform Matricës së akteve ligjore dhe nënligjore të parashikuara për vitin 2018.
16. Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për implementimin e projekteve me financim të huaj, mbështetur ne Planin Vjetor të Reformes si dhe ndjekja dhe monitorimi i projekteve dhe pagesave të projekteve të tjera të huaja (kosto lokale dhe TVSH). Raportimi në Ministrinë e Financës dhe Këshillin e Ministrave **për çdo muaj** sipas kërkesave specifike.
17. Monitorime analiza për produktet kryesore, si numri i punonjësve, pagave të punonjësve si dhe shpenzime personeli në Arsim, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, tekstet shkollore dhe kompesimi i tyre, investimet kapitale, si dhe trajtimi i problematikave në arsimin e lartë në IAL publike, etj.
18. Pjesëmarrje në grupe pune në MASR për hartimin udhëzimeve rregullore, apo akte të tjera nënligjore në kuadër të reformës në arsim.
19. Pjesëmarrje në gjashtë grupe pune në MASR monitorime “Për vlerësim për kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në IAL publike si dhe private”.
20. Realizimi i rishpërndarjeve të fondeve t buxhetin për vitin 2018, miratuar me ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”.
21. Pjesëmarrje në grupe pune në MASR për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për procedura prokurimi të parashikuara për vitin 2018.
22. **Hartimi i projektvendimeve të hartura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**, si dhe hedhja në sistem e projektvendimeve, për të cilat jemi ngarkuar.
23. Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtari”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, **janë realizuar analiza dhe dërguar raporte dhe informacione për Titullarët dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për vitin 2017, për çdo 3-mujor për vitin 2018, s dhe detyrimet akumuluar deri më 31 Dhjetor 2018**, i detajuar me të dhëna lidhur me;
  - a) *Historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikat e situatës, shkaqet dhe arsytet e pamundësisë së deritanishme për të shlyer këto detyrime, masat konkrete të marra deri tani në këtë drejtim;*
  - b) *Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluar deri në 31 Dhjetor 2018;*
  - c) *Vlera e likuiduar e detyrimeve të prapambetura deri më 31 Dhjetor 2018;*
  - d) *Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitit 2019, si edhe për një periudhë afat-mesme.*
24. Monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve, përdoren një sërë procedurash **nga titullarët**, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA.

**Objektiv 5). Auditimi i 30% dhe inspektimi në 10-12% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.**

#### **Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, për vitin 2018;**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2018, sipas planin vjetor të miratuar nga Ministri me nr. me prot/ nr. 10340, datë 12.10.2017, ka përcaktuar objektivat me programe konkrete, për realizimin e misionit të auditimit si:

- dhënies përparësi për auditim, atyre fushave që janë vlerësuar me rrishtë të mesëm dhe të lartë,
- përmirësimin e kapaciteteve të auditit,
- përmirësimin e programeve dhe metodologjisë së auditimit,

Për periudhën raportuese, Njësia e Auditimit, ka audituar kryesisht institucionet e vlerësuara me fonde të mëdha dhe të vlerësuara me risk në lidhje me përdorimin e fondeve, si dhe sisteme të ndryshme me risk të mesëm dhe të lartë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në institucionet e audituara, ka kryer vlerësimin sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga këto vlerësime vërehet se, ka raste që këto sisteme janë ngritur por janë vlerësuar me nivel të dobët ose nuk funksionojnë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

#### ▪ **Analiza e programeve të AB, për periudhën raportuese:**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë vitit 2018, i ka realizuar objektivat e parashikuara në planin vjetor të miratuar nga Ministri me prot/ nr. 10340, datë 12.10.2017.

Hartimi i planit vjetor të punës së DAB për vitin 2018, është bazuar në kapacitetet e burimeve që ka kjo drejtori, në vlerësimin e riskut duke i dhënë prioritet institucioneve të mëdha dhe me më shumë fonde.

Për vitin 2018, në mbështetje të planit vjetor, ishin planifikuar për t'u realizuar 18 auditime të kombinuara në 18 institucione. Në fakt janë realizuar 17 auditime të kombinuara dhe dy auditime tematike, në 19 institucione.

Janë dhënë një numër rekomandimesh, theksojmë se këto rekomandime kanë nivel të lartë pranimit nga Njësia Publike të audituara, por niveli i zbatimit të tyre nuk mund të përcaktohet qartë deri në përfundimin e afateve raportuese. Procesi i zbatimit të rekomandimeve është në ndjekje të vazhdueshme si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

#### **DAB, ka dhënë rekomandime, për të gjithë sistemin e MASR, si më poshtë:**

Gjatë vitit 2018, janë dhënë 45 rekomandime:

- a. **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, gjithsej 3;**

- Sistemi i kontrollit të brendshëm për funksionimin e njësive shpenzuese, për plotësimin e organikave.
- **Rekomandime të karakterit organizativ**, gjithsej 33 ; Sistemin e numrit të nxënësve në klasa; Funksionimi i Bordeve të administrimit; Sistemi i raportimeve dhe mirëqeverisjes.
- **Rekomandime për arkëtime**, gjithsej 8; Arkëtimi i tarifës së shkollimit për pagesa të ndryshme në kundërshtim me aktet ligjore si dhe arkëtime të tarifave të studimit.
- **Rekomandimet**, në mënyrë analitike sipas Institucioneve.

a. **Rekomandime për përmirësimin e sistemeve:**

- Menjëherë të merren masat dhe të veprohet sipas procedurave ligjore për plotësimin e pozicioneve të strukturave organike të pa plotësuar, në këto institucione: Zyrën Arsimor Gramsh, Zyrën Arsimor Tepelene, Zyrën Arsimor Mallakastër, Zyrën Arsimor Mirdite, Zyrën Arsimor Përmet, Zyrën Arsimor Kamëz, Dar Fier, Dar Elbasan.
- Menjëherë të fillojë studimi për përqendrimin e shkollave, me nxënësve të kufizuar në Zyrën Arsimor Gramsh.
- Të rishikohet struktura e personelit akademik, ndihmës akademik, si dhe administrativ në përputhje me ligjin nr.80/2015 si dhe nga ana e drejtorisë ekonomike të propozohen ndryshime në VKM për përputhjen e kategorizimit të personelit akademik me ligjin nr. 80/2015, Universiteti i Sporteve, Universiteti i Vlorës

b. **Rekomandime të karakterit organizativ:**

- Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, si përfitues i fondeve “grand/transferte korrente e brendshme, të paraqes në MASR dokumentacionin e përcaktuar në pikën 6 të Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014.
- Të raportohen në MASR të ardhurat e përfituara nga burime të tjera të ligjshme, në zbatim të pikës 12 të udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014. - Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
- Të ngrihet një komision “At-hok” për asgjësimin e kontingjenteve të teksteve shkollore gjendje që janë jashtë katalogut, si rekomandim i pa realizuar lënë nga auditimi i mëparshëm.

c. **Rekomandime për arkëtime:**

**Për Universitetin e Vlorës:** Pesë anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm institucional në kuadër të akreditimit të arkëtojnë shumën 610.571 leke. Anëtarët e senatit akademik dhe Kryetari të arkëtojnë shumat respektive 30.000 dhe 35.000 lekë, pasi janë paguar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të arkëtohen pagesat e përfituara për orë jashtë orarit nga punonjësit sipas urdhër shpenzimit nr.333, datë 08.11.2017 në shumën 2.063.293 lekë dhe urdhër shpenzimit nr.265, datë 05.10.2017 në shumën 1.606.500 lekë. Të gjithë përgjegjësit e sektorëve në rektorat të arkëtojnë diferencën e pagës së përfituar me IIIb nga kategoria IV/a që i takon sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017, lidhja nr.7. Të arkëtohen pagesat e përfituara për orë jashtë orarit nga punonjësit sipas urdhër shpenzimit nr.333, datë 08.11.2017 në shumën 2.063.293 lekë dhe urdhër shpenzimit nr.265, datë 05.10.2017 në shumën 1.606.500 lekë.

**Universiteti i Sporteve,** të arkëtohet vlera totale prej 18.974.738 lekë, tarifë shkollimi e pa arkëtuar nga studentët.

**Federata Volejbollit,** llogaritja e vjetërsisë në punë, për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe pozicionin e specialistit të bëhet mbi vlerën e pagës së grupit dhe jo mbi vlerën e pozicionit.

**ZA Gramsh,** menjëherë të fillojë ndalesat për 2 persona në shumën 18200 leke,.

**ZA Mallakastër,** të bëhet ndalesa për 8 punonjës paguar padrejtësisht për lejen e zakonshme për vitin 2017, me vlerë 481 236 lekë.

## **Inspektorati Shtetëror i Arsimit për vitin 2018.**

Përgjatë vitit 2018, ISHA ka zhvilluar veprimtarinë e tij duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MASR. **ISHA ka zhvilluar funksionet e saj me veprimtari, të tilla si:** vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore; kontrolli i pajtueshmërisë të veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore; monitorimi i teksteve shkollore; monitorimi i zbatimit të Dispozitave Normative, i Kodit të Etikës së mësuesit, punës së bordit të shkollës dhe të organeve kolegjiale të saj; monitorimi, vlerësimi, nxjerrja e përfundimeve dhe këshillimi për zhvillimin e arsimit parauniversitar; informimi i Ministrit, njësive arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e inspektimeve arsimore; si dhe publikimi i veprimtarive të inspektimeve dhe vendimeve të marra nëpërmjet faqes zyrtare [ëëë.isha.gov.al](http://eëë.isha.gov.al).

*Gjatë vitit 2018 ISHA ka realizuar, 128 inspektime të programuara, përkatësisht:*

**13 inspektime të plota:** në 4 kopshte, 4 shkolla të arsimit bazë dhe 5 gjimnaze, me qëllim vlerësimin e cilësisë së ofruar nga institucioni arsimor, mbështetur në fushat e udhëzuesve zyrtar “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës” dhe “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit”, të përditësuara me Dispozitat Normative 2013 dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore.

*115 inspektime tematike për:*

- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në planifikimin vjetor lëndor dhe vlerësimin bazuar në kurrikulën me kompetenca;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar për mësimdhënien në lëndën e edukimit fizik;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në procesin e hartimit dhe zbatimit të projekteve lëndore dhe ndër-lëndore;
- vlerësimin e shkollës për cilësinë e ofruar në menaxhimin e shkollës dhe klimën, etikën dhe kujdesin ndaj nxënësit;
- verifikimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në realizimin e procesit të praktikave profesionale për mësuesit;

- verifikimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë lidhur me funksionimin e institucioneve arsimore private bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
- verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë inspektimeve të zhvilluara në institucione arsimore parauniversitare;
- verifikimin e zhvillimit të procesit për realizimin e Kartës së Performancës së Shkollës;
- riinspektimin e realizimit të rekomandimeve të lëna.

#### **44 inspektime të orientuara jashtë programit, ndër të cilat:**

- 5 për vlerësimin e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore private, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 39 për shqyrtimin e rasteve të ankimeve, përkatësisht 28 raste nëpërmjet komunikimit me DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore përkatëse dhe 11 nëpërmjet inspektimeve të drejtpërdrejta me autorizim/Urdhër MASR-i në terren.

**Objektiv 6). Trajnimi çdo vit për 80-100 drejtuesve të institucioneve arsimore, për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë. *Ky objektivi është shtyrë për u realizuara në kuadër të miratimit të shkollës së drejtorëve miratuar me VKM.***

## **II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)**

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushtetë barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar. Arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomisë së shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB. Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtirja e shërbimit të punonjësve social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

**Fondet e planifikuara për vitin 2018, janë në MASR 22 miliard e 174 milion lekë.** Fondet e programit të arsimit bazë të arrijnë 57.4 % e fondeve të MASR. Fondet e rishikuara për këtë program për vitin 2018 janë në 55 miliard e 55 milion lekë, së bashku me të ardhurat dytësore dhe të projekteve donatore arrijnë në 22 miliard e 90 milion lekë ose në 52.6 %, **si dhe 4.44% ndaj shpenzimeve publike dhe 1.34% ndaj PBB%.**

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018 është në masën 21 miliard e 860 milion lekë ose në 99% e fondeve të rishikuara të programit për periudhën 12- mujore 2018.

Fondet e arsimit bazë zënë rreth 53.3% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë **si dhe 4.4% ndaj shpenzimeve publike dhe 1.33% ndaj PBB%.**

**Ndër objektivat dhe produktet/ aktivitetet/ shërbimet që janë financuar me përparësi, në këtë grup shpenzimesh për vitin 2018;**

- a) Vlerësimi i punonjësve të arsimit, shpenzime për personelin për vitin 2018, **janë në masën 25 miliard e 770 milion lekë ose në masën 67.2% e fondeve të miratuara për arsimin për vitin 2018;** Fondet e miratuara për shpenzime personeli përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, të numrin të miratuar të punonjësive prej 31,004 punonjës të arsimit, si dhe 1,500 praktikantëve që realizojnë praktikën profesionale në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar, **ku përfitues të shërbimit arsimor janë 457,831 fëmijë dhe nxënës.** Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2018 janë rreth 67.2% e buxhetit të arsimit, ndërsa ndaj shpenzimeve totalit të shpenzimeve korente janë në masën 72.5 %.

**Trajtimin me një kompensim shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar, ku përveç pagës, punonjësit mësimorë, që punojnë larg vendbanimit, përfitojnë një kompensim në masën, si më poshtë vijon:**

4.a) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 2 700 (dy mijë e shtatëqind ) lekë në muaj.


4.b) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, **nga kjo masë përfitojnë rreth 11 400 punonjës mësimorë me një fond prej 200 milion lekë në vit.**

- b) **Financimi i aktiviteteve të parashikuara për arsimin parashkollor, aktualisht rreth 85% e fëmijëve 3-6 vjeç ndjekin arsimin parashkollor.** Në 2018 të sigurohet aksesi i fëmijëve në arsimin parashkollor në nivelin 85-86% per grupmoshën 3-6 vjeç. në 2020 do të sigurohet në nivelin 95-100% aksesi i fëmijëve te grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor **ku përfitues janë 73 884 fëmijë me një fond prej 30.2 milion lekë.** Burimet njerëzore ku përfshihen rreth 4400 mësues dhe edukatorë si dhe 3 100 punonjës në shërbimet e arsimit parauniversitar, dhe fondet në shumën prej 5.5 miliard lekë për këtë shërbim janë decentralizuar dhe aktualisht menaxhohen në nivelet e vetëqeverisjes vendore.

- c) **Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin 30-32 mijë nxënësve dhe fëmijëve** që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e **9 086 mësuesve që punojnë mbi 5 Km** nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, konform kërkesave të VKM nr.692, datë 29.7.2015 në shumën 620 milion lekë në vit. Nga të cilat rreth 307 milion leke përfitohen nga 9 086 punonjësit mësimorë dhe 313 milion leke nga 30-32 mijë nxënës dhe fëmijë në të gjithë vendin.
- d) **Ofrimi i teksteve shkollore.** Për herë të parë janë tekstet dhënë tekstet shkollore falas në përdorim për të gjithë nxënësit nga klasa e parë në klasën e katër, si dhe nxënës të 16 kategorive sociale nga klasa e pestë në klasën e nëntë duke sigurua që rreth **166,898 nxënës ose 62.4% e nxënësve të arsimit bazë nga 296,736 fa nxënësit e klasës I-IX, për të mbuluar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore për rreth 166,898 nxënës** të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë shuma e realizuar prej 502.6 milion lekë në vit.
- e) **Ofrimi i kuotës ushqimore, bursa me fonde të buxhetit të shtetit, për të mbuluar shpenzimet për kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta,** për rreth 1400 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë shuma parashikuar prej 28 milion lekë në vit. (këtu nuk përfshihen rreth 6-7 mijë nxënës të arsimit profesional të cilët përfitojnë bursë nga Programi i AFP-së)
- f) **Rishikimin e kurikulës dhe hartimin e programeve të reja të arsimit para-universitar për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit janë planifikuar 43.7 milion lekë në vit fonde të buxhetit.**
- g) **Fonde për të mbuluar shpenzimet për blerje materiale didaktike mësimore të arsimit para-universitar 50 milion lekë në vit, ku përfitues janë 296 736 nxënës.**
- h) **Mbi arsimin gjithpërfshirës,** deri në vitin 2020 do të sigurohet arsim cilësor dhe gjithpërfshirës më synim 100% e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin 9-vjeçar. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me AK , ndaj vitit paraardhës. Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK. Gjithashtu do të synohet deri në 2020 dyfishimi i mësuesve ndihmës për fëmijët me AK. **Nga 640 mësues që janë aktualisht me një efekt financiar vjetor prej 630 milion lekë.**
- i) **Mbi kurrikulën e re të arsimit parauniversitar.** Aktualisht, punojnë me kurrikulen e re bazuar në kompetenca si dhe me tekste të reja kl. I, II, III, VI, VII, VIII, X, XI. Deri në 2020, i gjithë sistemi arsimor parauniversitar do të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE, ku përfitues janë 100% e nxënësve të arsimit parauniversitar më **një fond prej 43.7 milion lekë.**
- j) **Mbi Shërbimin Psiko-Social,** Aktualisht ShPS në shkollat e arsimit të mesëm të lartë ofrohet sipas kësaj norme: Një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800-3,500 nxënës. Deri në vitin 2020 çdo shkollë e mesme me mbi 700 nxënës do të ketë një psikolog dhe/ose një punonjës social. Ndërsa në arsimin bazë kërkohet të dyfishohet numri i psikologeve dhe punonjësve sociale me një efekt **financiar vjetor prej 686.2 milion lekë.**
- k) **Mbi Zhvillimin Profesional të mësuesve, për vitin 2018 janë trajnuar 22129 mësues,** më qëllim që të sigurohet efektivitet dhe cilësia e veprimtarive për zhvillimin profesional mbështetur mbi nevojat për mësuesit dhe drejtuesit e insitucioneve shkollore si në nivel shkolle ashtu dhe ato të ofruara përmes sistemit kërkesë/ofertë. Në këtë skemë janë edhe trajnimet e mësuesve të diasporës dhe minoriteteve. Përkatësisht trajnimi i 40 mësuesve të minoriteteve dhe trajnimi i 70 mësuesve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Fonde për të mbuluar shpenzimet për trajnimin të punonjësve mësimorë të arsimit para-universitar janë realizuar në masën **62.7 milion lekë në vit.**
- l) **Mbi Shkollat Qendër Komunitare,** në vitin 2018 ëshë rritur me 20% numri i shkollave SHQK. Nga 225 shkolla aktualisht do të shtohen edhe 50 shkolla të tjera. Çdo shkollë SHQK ka 10 orë mësimi në dispozicion për realizimin e aktiviteteve të ShQK-së, çka nënkupton se për 50 shkolla të reja, nevojiten 500 orë mësimore në javë, të cilat do të zhvillohen jashtë procesit mësimor **me një efekt financiar vjetor prej 26.5 milion lekë.**
- m) **U realizua testimi sipas portalit “Mësues për Shqipërinë”.** U hartuan 20 programe orientuese, u hartuan 40 teste sipas profileve, u përgatitën 3110 teste sipas profileve, u realizua testimi për 3110 mësues. U publikua për çdo DAR renditja e mësuesve sipas vlerësimit në testim dhe nëpërmjet dosjeve personale të dorëzuara në DAR. Është hartuar udhëzimi nr.1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve mësimorë”.



| ANEKSI Nr. 2   |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
|--|---|----------------------------|----------------------------|---------------------|---------------------|-------------------------------|---|----------------------------|---------------------------------------|---------------|
| mit sipas Artikutjeve per Buxhetin 2018 (cdo 4 mujor progresive) |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| ne 000 leke  |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| 12 mujori 2018   |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| ne 000 leke  |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| Ministria  | MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            | Kodi                                  | 11            |
| Programi   | Arsimi Baze                             |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            | Titulli                               | 09120         |
| <b>Totali Shpenzimeve</b>  |   |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| Artikulli  | 0                                       | 1                          | 2                          | 3                   | 4                   | 5                             | 6                                       | (7)=(6)-(5)                | Realizime % ndaj planit 12-mujor 2018 |               |
| <b>Kodi</b>  | <b>Emri</b>                             | <b>Fakti 12-mujor 2016</b> | <b>Fakti 12 mujor 2017</b> | <b>PBA 2018</b>     | <b>Buxheti 2018</b> | <b>Buxheti rishikuar 2018</b> | <b>Buxheti peridudhes 12 mujor 2018</b> | <b>Fakti 12 mujor 2018</b> | <b>Diferenca 2018</b>                 |               |
| 600  | Paga                                    | 15,308,648                 | 15,845,529                 | 15,453,226.0        | 16,491,206          | 16,160,480.3                  | 16,160,480.3                            | 16,106,574                 | 53,906.8                              | 99.7%         |
| 601  | Sigurime Shqetore                       | 2,562,257                  | 2,637,550                  | 2,561,074.0         | 2,671,574           | 2,710,774.0                   | 2,710,774.0                             | 2,694,641                  | 16,132.6                              | 99.4%         |
| 602  | Mallra dhe Shetrbime te Tjera           | 742,071                    | 752,256                    | 1,523,800.0         | 723,800             | 921,121                       | 921,121                                 | 886,138                    | 34,982.7                              | 96.2%         |
| 603  | Subvencione                             |                            |                            | 0.0                 | 0                   | 0                             | 0                                       | 0                          | 0                                     | 0.0%          |
| 604  | Transferta Korente te Bredshme          |                            |                            | 0.0                 | 0                   | 0                             | 0                                       | 0                          | 0                                     | 0.0%          |
| 605  | Transferta Korente te Huaja             | 141.5                      | 138.3                      | 0.0                 | 0                   | 145                           | 145.0                                   | 130                        | 14.8                                  | 89.8%         |
| 606  | Trans per Bush, Fam & Individ           | 273,342                    | 302,789                    | 270,000.0           | 530,000             | 567,600                       | 567,600                                 | 534,282                    | 33,318.0                              | 94.1%         |
| <b>Nen-Totali</b>  | <b>Shpenzime Korrente</b>               | <b>18,886,460</b>          | <b>19,538,261</b>          | <b>19,808,100</b>   | <b>20,416,580</b>   | <b>20,360,120</b>             | <b>20,360,120</b>                       | <b>20,221,765</b>          | <b>138,355</b>                        | <b>99.3%</b>  |
| 230  | Kapitale te Patrupezuara                | 0.0                        | 0.0                        | 0                   | 0                   | 0                             | 0                                       | 0.0                        | 0.0                                   | 0.0%          |
| 231  | Kapitale te Trupezuara                  | 1,069,612.3                | 1,153,752.4                | 1,369,205           | 1,757,947           | 1,694,947                     | 1,694,947                               | 1,603,616.7                | 91,330                                | 94.6%         |
| 232  | Transferta kapitale                     |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| <b>Nen-Totali</b>  | <b>Shpenzime Kapitale fin Bredshem</b>  | <b>1,069,612</b>           | <b>1,153,752</b>           | <b>1,369,205</b>    | <b>1,757,947</b>    | <b>1,694,947</b>              | <b>1,694,947</b>                        | <b>1,603,617</b>           | <b>91,330</b>                         | <b>94.6%</b>  |
| 230  | Kapitale te Patrupezuara                |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| 231  | Kapitale te Trupezuara                  |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| 232  | Transferta kapitale                     |                            |                            |                     |                     |                               |   |                            |                                       |               |
| <b>Nen-Totali</b>  | <b>Shpenzime Kapitale fin Huaj</b>      | <b>0</b>                   | <b>0</b>                   | <b>0</b>            | <b>0</b>            | <b>0</b>                      | <b>0</b>                                | <b>0</b>                   | <b>0</b>                              | <b>0.0%</b>   |
| <b>Totali</b>  | <b>Korrente dhe Kapitale</b>            | <b>19,956,072.1</b>        | <b>20,692,013.4</b>        | <b>21,177,305.0</b> | <b>22,174,527.0</b> | <b>22,055,066.9</b>           | <b>22,055,066.9</b>                     | <b>21,825,381.7</b>        | <b>229,685.1</b>                      | <b>99.0%</b>  |
| <b>ishte Buxhetore</b>   |   | <b>46,228.9</b>            | <b>27,395.1</b>            | <b>0.0</b>          | <b>0.0</b>          | <b>35,394.4</b>               | <b>35,394.4</b>                         | <b>35,394.4</b>            | <b>0.0</b>                            | <b>100.0%</b> |
| <b>370.620 Nr. Fraqe 73884-296736 nomen -37062</b>               |   | <b>50.1</b>                | <b>51.9</b>                |                     | kosto nxenes        | kosto nxenes                  | kosto nxenes                            |                            | <b>59.0</b>                           |               |
| <b>+ kapitale + jashte buxhetore)</b>                            |   | <b>20,002,301</b>          | <b>20,719,408</b>          | <b>21,177,305</b>   | <b>22,174,527</b>   | <b>22,090,461</b>             | <b>22,090,461</b>                       | <b>21,860,776</b>          | <b>229,685</b>                        | <b>99.0%</b>  |
| Ndaj PBB ne %  |   | 1.36%                      | 1.33%                      | 1.29%               | 1.35%               | 1.34%                         | 1.34%                                   | 1.33%                      | 0.01%                                 |               |
| Shpenzimet Totale te konsoliduara ne %                           |   | 4.61%                      | 4.49%                      | 4.26%               | 4.46%               | 4.44%                         | 4.44%                                   | 4.40%                      | 0.05%                                 |               |



**Objektiv 1.** Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor në nivelin 85-86% e grupmoshës 3-6vjeç. Reformimi i arsimit parashkollor, përmes miratimit të kornizës së re kurrikulare dhe programeve për cdo grupmoshë për arsimin parashkollor, trajnimin të 900-1000 mësuesve/ edukatorëve (15-20% në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (100-120 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me materiale didaktike. **Veprimtaritë sipas objektivit 1:**

*Hartimi i programeve lëndore* për të gjitha ciklet (**arsimi parashkollor** dhe klasat 1-12). Këto programe zhvillojnë kompetencat kyç, bazuar në ato evropiane, dhe strukturohen sipas rezultateve të të nxënimit për kompetenca të fushës ose lëndore.

Të hartojë paketën kurrikulare sipas qasjes me kompetenca në arsimin parashkollor.

- **Plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin parashkollor** ka pasur në fokus hartimin e dokumentacionit të plotë kurrikular për këtë nivel arsimor. Kjo paketë kurrikulare përmban hartimin dhe miratimin e kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor, standardet e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç dhe programet për moshën 3-6 vjeç. Gjatë vitit 2018 u hartuan dhe u miratuan programet për moshën 4-5 vjeç dhe standardet e profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor.
- **Veprimtaritë për realizimin e objektivit:** Për realizimin e këtij objektivit sektori i zhvillimit të kurrikulës dhe i standardeve, përmes specialistëve të tij përgjegjës për hartimin e këtyre dokumenteve, ka kryer veprimtaritë e mëposhtme:

**Për programet e grupit të dytë të kopshtit (mosha 4-5 vjeç)**

- u ngrit grupi i punës me specialistë të IZHA-s, bashkëpunëtorë, mësues, pedagogë dhe drejtues të institucioneve parashkollore;
- u diskutua dhe u përcaktua struktura e programeve të grupit të dytë;
- u hartuan draftet e para të programeve të grupit të dytë;
- u prezantuan dhe u diskutuan programet në tryeza të rumbullakëta;
- u miratuan nga MASR programet e grupit të dytë;
- u publikuan në faqen e IZHA-s programet e grupit të dytë të kopshtit, mosha 4-5 vjeç.

**Për standardet e mësuesit të arsimit parashkollor**

- u ngrit grupi i punës me specialistë të IZHA-s, bashkëpunëtorë, mësues, pedagogë dhe drejtues të institucioneve parashkollore;
- u diskutua dhe u përcaktua struktura e standardeve të mësuesit të arsimit parashkollor;
- u hartua drafti i parë i standardeve të mësuesit të arsimit parashkollor;
- u prezantua dhe u diskutua drafti i standardeve në tryeza të rumbullakëta;
- u miratuan nga MASR standardet e mësuesit të arsimit parashkollor;

Bashkëpunimi me organizatën “Save the children” në fushën e arsimit parashkollor, i cili ka pasur si objektiva: *informimin* e vazhdueshëm i mësuesve dhe drejtuesve të 8 kopshteve të projektit në DAR Shkodër, ZA Mat, DAR Elbasan dhe DAR Tirana qark për ndryshimet e sjella nga reforma kurrikulare në arsimin parashkollor, *trajnimin* e tyre me risitë dhe zhvillimet më të fundit në edukimin parashkollor, *monitorimin* e pilotimit të instrumentit ndërkombëtar IDELA. Gjithashtu, janë realizuar trajnime me Save the Children për modulet e akredituara nga KAPT (për të lexuarit, për indeksin për gjithpërfshirjen në shkollë, si dhe për zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës së re). Bashkëpunimi me UNICEF-in në fushën e arsimit parashkollor, i cili ka pasur si objektiva: *trajnimin e mësuesve të arsimit parashkollor me metodologjinë ËANDA*, *sigurimin e ekspertizës ndërkombëtare për hartimin e kornizës së vlerësimit në arsimin parashkollor*, *realizimin e konferencës së arsimit parashkollor për prezantimin e reformave në këtë nivel*.

Në vitin shkollor 2017-2018 janë regjistruar dhe ndjekin arsin parashkollor 81,026 fëmijë ose rreth 80-82% e fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, nga të cilët 73 884 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç të regjistruar dhe ndjekin arsin parashkollor në institucione publike vitin shkollor 2017-2018.

**Shqipëria duhet t'i japë përparësi viteve të hershme**, nga parashkollori deri në klasën e tretë, në mënyrë që të sigurojë një bazë të fortë gjuhësore dhe numerike.

Duhet të ketë përmirësim të infrastrukturës dhe të bazës materiale për qëllime mësimore. Të organizohet zhvillimi profesional i drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor për dokumentacionin e ri kurrikular.

|                    | Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe Përqindjet përkatëse sipas Niveleve të Arsimit 2017-2018 |                          |                             |                  |                             |                     |                             |                          |                                 |
|--------------------|---|--------------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|---------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------------------|
|                    | Arsimi Publik   | Arsimi Parashkollor (AP) | Përqindja Nx. AP / Gjithsej | Arsimi Bazë (AB) | Përqindja Nx. AB / Gjithsej | Arsimi i Mesëm (AM) | Përqindja Nx. AM / Gjithsej | Arsimi mesem profesional | Përqindja Nx. AM prof/ Gjithsej |
| Nr. i Nxënësve     | 476747  | 73,884                   | 15.50%                      | 296,736          | 62.24%                      | 87211               | 18.29%                      | 18916                    | 3.97%                           |
| Nr. Institucioneve | 3173  | 1777                     | 51.37%                      | 1220             | 35.27%                      | 347                 | 10.03%                      | 33                       | 1.04%                           |
| Nr. i Mësuesve     | 34181   | 4201                     | 12.29%                      | 22644            | 66.25%                      | 6275                | 18.36%                      | 1061                     | 3.10%                           |

| Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe Përqindjet përkatëse sipas Niveleve të Arsimit 2017-2018 |                                     |                          |                             |                  |                             |                     |                             |                          |                                 |
|---|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|---------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------------------|
|   | Gjithsej në Arsimin Parauniversitar | Arsimi Parashkollor (AP) | Përqindja Nx. AP / Gjithsej | Arsimi Bazë (AB) | Përqindja Nx. AB / Gjithsej | Arsimi i Mesëm (AM) | Përqindja Nx. AM / Gjithsej | Arsimi mesem profesional | Përqindja Nx. AM prof/ Gjithsej |
| Nr. i Nxënësve  | 520,759                             | 81,026                   | 15.56%                      | 319,671          | 61.39%                      | 99,457              | 19.10%                      | 20,605                   | 3.96%                           |
| Nr. Institucioneve  | 3,484                               | 1,919                    | 50.51%                      | 1,345            | 35.40%                      | 454                 | 11.95%                      | 41                       | 1.18%                           |
| Nr. i Mësuesve  | 38,471                              | 4,740                    | 12.32%                      | 24,790           | 64.44%                      | 7,687               | 19.98%                      | 1,254                    | 3.26%                           |

| Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe % sipas Niveleve të Arsimit (Arsimi Publik dhe Privat) Viti Shkollor 2016-2017 |                                     |                          |                             |                  |                             |                     |                             |                          |                                 |
|---|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|---------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------------------|
|   | Gjithsej në Arsimin Parauniversitar | Arsimi Parashkollor (AP) | Përqindja Nx. AP / Gjithsej | Arsimi Bazë (AB) | Përqindja Nx. AB / Gjithsej | Arsimi i Mesëm (AM) | Përqindja Nx. AM / Gjithsej | Arsimi mesem profesional | Përqindja Nx. AM prof/ Gjithsej |
| Nr. i Nxënësve  | 542,818                             | 87,600                   | 16%                         | 328,100          | 60%                         | 106,137             | 20%                         | 20,981                   | 4%                              |
| Nr. Institucion   | 3,807                               | 2,221                    | 58%                         | 1,370            | 36%                         | 451                 | 12%                         | 45                       | 1%                              |
| Nr. i Mësuesve  | 39,018                              | 5,110                    | 13%                         | 24,866           | 64%                         | 7,765               | 20%                         | 1,277                    | 3%                              |

**Objektiv 2; Zbatimi/Implementimi i kurrikulës** së re (kl 1-3- dhe kl 6-8), hartimi i kurrikulës/ programeve të reja (kl 4,5 dhe kl 9 e përfunduar) përgatitja e 25 programeve kualifikues, 12 module trajnimi, 40 teste trajnuese për kurrikulën e re. Hartimi i programeve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, sportiv dhe gjuhë të huaja, arsimit parauniversitar. Trajnimi i 12.000 mësuesve të kl 2 dhe 7 (25% të mësuesve të AB) për kurrikulën e re. Në trajnimin për kurrikulën e re përfshihet dhe trajnimi i 40 mësuesve të minoriteteve. Trajnimi i 70 mësuesve të diasporës në seminarin mbarëkombëtar për mësuesit e diasporës. Zhvillimi i vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe i provimeve kombëtare të lirisimit. Pilotimi i PISA-s.

**Mbi kurrikulën e re të arsimit parauniversitar.** Aktualisht, punojnë me kurrikulën e re bazuar në kompetenca si dhe me tekste të reja kl. I, II, III, IV, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII. Deri në 2020, i gjithë sistemi arsimor parauniversitar do të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE.

**Mbi Zhvillimin Profesional të mësuesve,** për vitin 2018 janë trajnuar 12 000 mësues me qëllim që të sigurohet efektiviteti dhe cilësia e veprimtarive për zhvillimin profesional mbështetur mbi nevojat për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve shkollore si në nivel shkolle ashtu dhe ato të ofruara përmes sistemit kërkesë/ofertë. Në këtë skemë janë përfshirë edhe trajnimet e mësuesve të diasporës dhe minoriteteve. Përkatësisht trajnimi i 40 mësuesve të minoriteteve dhe trajnimi i 70 mësuesve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Fonde për të mbuluar shpenzimet për trajnimin çdo vit të 10-15% të punonjësve mësimorë të arsimit para-universitar 60 milion lekë në vit.

**Zbatimi i reformës kurrikulare ka nisur me pilotimin e kurrikulës me kompetenca.** Ky proces shërbeu për sensibilizimin e opinionit publik, kualifikimin e mësuesve, përgatitjen e plotë të programeve për zbatim, si dhe për korrigjime dhe reflektime të mundshme pas pilotimit. Pilotimi u krye në 26 shkolla në 13 rrethe të vendit, duke përfshirë zonën urbane dhe rurale. Gjatë vitit shkollor 2014-2015 filloi pilotimi i paketës kurrikulare të dokumenteve të hartuar nga IZHA sipas skemës më poshtë:

- Në vitin shkollor 2014-2015 u pilotuan klasa përgatitore, klasa I dhe klasa VI.
- Në vitin shkollor 2015-2016 u pilotuan klasat II dhe VII. Filloi zbatimi në të gjitha klasat I dhe VI.
- Në vitin shkollor 2016-2017 u pilotuan klasat III dhe VIII. Filloi zbatimi në të gjitha klasat II dhe VII dhe X.
- Në vitin shkollor 2017-2018 u pilotuan klasat IV dhe IX. Filloi zbatimi në të gjitha klasat III dhe VIII dhe XI.
- Në vitin shkollor 2018-2019 u pilotua klasa V. Filloi zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha klasat IV, IX dhe XII.
- Në vitin shkollor 2019-2020 fillon zbatimi i kurrikulës së re në të gjitha klasat V.

Për realizimin e këtij objekti, u realizuan këto veprimtari:

- u hartuan draftet e programeve për pilotimin e kurrikulës së klasës V, në lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj e parë, matematikë, dituri natyre, histori, qytetari, TIK, muzikë, art pamor, aftësim teknologjik, edukim fizik, sporte dhe shëndet;

- u diskutuan draftet e programeve me mësuesit e shkollave pilot;
- u hartuan variantet përfundimtare të programeve të kurrikulës së klasës së pestë dhe u miratuan në MASR.

**Plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin bazë** ka të bëjë me hartimin e udhëzuesve kurrikularë lëndorë. Këta udhëzues janë hartuar sipas profileve lëndore në ndihmë të mësuesve të arsimit bazë me shembuj konkretë dhe praktikë për zbatimin e kurrikulës në klasat 6 – 9. Udhëzuesit kanë në fokus zbatimin e metodave dhe të teknikave për zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe kompetencave lëndore, vlerësimin për të nxënë, vlerësimin e të nxënësve, vlerësimin e portofolit, hapat e hartimit të testeve me kompetenca etj. **Veprimtaritë për realizimin e objektivit:** Për realizimin e këtij objekti, sektori i zhvillimit të kurrikulës dhe të standardeve, përmes specialistëve përgjegjës për secilin udhëzues dhe bashkëpunëtorëve të përzgjedhur për këtë qëllim, kanë kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- janë ngritur 13 grupe pune me specialistë të IZHA-s, bashkëpunëtorë, mësues sipas profileve për arsimin bazë dhe arsimin fillor;
- u diskutua dhe u përcaktua struktura e udhëzuesit;
- u hartuan draftet e para të 13 udhëzuesve;
- u prezantuan dhe u diskutuan ndërmjet specialistëve dhe mësuesve në tryeza të rrumbullakëta të gjitha draftet e udhëzuesve;
- ka përfunduar hartimi i 13 udhëzuesve lëndorë të arsimit bazë, klasat 6 - 9: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, TIK, muzikë, art pamor, teatër, edukim fizik;
- është në proces hartimi i udhëzuesit të arsimit fillor dhe i profilit të shkencave sociale;
- janë publikuar në faqen e IZHA-s 13 udhëzuesit lëndorë të arsimit bazë, klasa 6-9.

**Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”** është një program, i cili u ofrohet të gjithë nxënësve të institucioneve arsimore në të cilat zbatohet kjo nismë. Ky program synon:

- sigurimin e kushteve dhe të mundësive të barabarta për nxenie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije;
- përmirësimin e arritjeve të nxënësve, përmes sigurimit të kohës, hapësirës dhe programeve shtesë që ofrohen pas mësimit për të gjithë nxënësit, duke i ndihmuar ata në kryerjen e detyrave të shtëpisë;
- nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve në fusha të caktuara përmes aktiviteteve jashtë kurrikulare që organizon shkolla;
- përmirësimin e klimës dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit në shkollë;
- mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e partneritetit me prindërit e anëtarë të tjerë të komunitetit, për t’iu përgjigjur sa më mirë përbushjes së nevojave fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

**Përgjatë vitit shkollor 2017- 2018, nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” u pilotua në 20 institucione arsimore të pesë Drejtorive Arsimore Rajonale, ndërsa në vitin shkollor 2018-2019 kjo nismë u shtri në rreth 90 institucione arsimore në të gjithë vendin.** Për zbatimin e kësaj nisme, si gjatë fazës së pilotimit ashtu dhe përgjatë zbatimit masiv të saj nga MASR u ngrit grupi teknik për zbatimin e nismës, në përbërje të cilit kishte dhe specialistë të DKSK (IZHA), të cilët krahas koordinimit dhe monitorimit të veprimtarive në disa prej shkollave të përfshira në nismë, u angazhuan në mënyrë të veçantë për hartimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”. Udhëzuesi për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” është një material ndihmës për institucionet arsimore dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (IAVPAP) të përfshira në zbatimin e nismës

**Nisma “Shkolla të sigurt – Oficerët e Sigurisë në shkolla”** është një iniciativë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MASR) dhe Ministria e Brendshme, e cila i jep një vëmendje të posaçme rritjes së sigurisë, si brenda ashtu dhe përreth institucioneve arsimore. Qëllimi i kësaj nisme të përbashkët është garantimi i një mjedisi të nxënësve të sigurt për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës. Përfshirja e rolit të oficerit të sigurisë në shkollë synon rritjen e sigurisë përmes mbështetjes dhe ndërveprimit me aktorët e shkollës. Përgjatë vitit shkollor 2017-2018, nisma u pilotua në të gjitha gjimnazet e Tiranës (15 gjimnaze), ku u atashuan 15 oficerë sigurie. Oficerët e sigurisë janë profesionistë të rinj dhe të reja, të përgatitur dhe të trajnuar për të përbushur rolet e tyre. Trajnimi i tyre është realizuar në bashkëpunim me Akademinë e Policisë bazuar në një paketë modulesh multidisiplinare, të konsultuar nga MASR dhe IZHA, në lidhje me tematikat:

- Menaxhimi i situatës në raste dhune në shkolla.
- Dhënia e ndihmës së shpejtë në rast nevoje.
- Teknika të zgjidhjes së problemeve.
- Legjislacioni bazë.
- Çështje gjinore.
- Psikologjia e të miturve.
- Njohja e shenjave të deviancës së adoleshentëve

**Objektiv 3, Zhvillimi i reformës së teksteve shkollore, përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore si dhe kompensimi i cmimit të teksteve shkollore nga klasa I-IX, në masën 100 % fëmijëve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, fëmijëve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijëve që gëzojnë statusin e të verbrit, fëmijëve të pakicave kombëtare, për nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve të familjeve të emigrantëve/fëmijë të familjeve që kanë në**

*përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë, viktimë të trafikimit.*

### **Veprimtaritë sipas objektivit 3:**

- a) Gjatë periudhës mars-prill 2018 MASR zhvilloi procesin për përzgjedhjen e teksteve të reja shkollore për klasat III, VIII sipas kurrikulës së re.
- b) Gjatë periudhës tetor 2017-qershor 2018 u mbledhën dhe u përpunuan vërejtjet e mësuesve, të cilët përdorën për një vit shkollor tekste të reja të klasave II, VII.
- c) Gjatë periudhës qershor-gusht 2018, vërejtjet e mësuesve për tekste të klasave II, VII, iu dërguan botuesve për korrigjim.
- d) Në muajin gusht 2018 u verifikuan dhe u konfirmuan korrigjimet e teksteve të klasave II, VII.
- e) MASR ka rishikuar Udhëzimin nr. 29, datë 02.08.2013 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme", ku trajtohet dhe shansi i dytë, me qëllim: hartimin e një plani mësimor të ri, të programeve të reja mbi bazë kompetencash si dhe lehtësira të mundshme për arsimimin me kohë të pjesshme dhe përmes shansit të dytë.

**Ofrimi i teksteve shkollore.** Për herë të parë janë tekstet dhënë tekstet shkollore falas në përdorim për të gjithë nxënësit nga klasa e parë në klasën e katër, si dhe nxënës të 16 kategorive sociale nga klasa e pestë në klasën e nëntë duke sigurua që **rreth 166,898 nxënës ose 62.4% e nxënësve të arsimit bazë nga 296,736 nxënës të klasës I-IX, për të mbuluar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore për rreth 166,898 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë shuma e realizuar prej 502.6 milion lekë në vit.**

Kategoritë sociale të nxënësve nga klasa e pestë në klasën e nëntë që vijnë të përfitojnë tekstet shkollore falas ose me rimbursim, pas blerjes.

- a) **Fëmijët vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti.**
- b) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimë të trafikimit,** të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.
- c) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme** të trafikimit në përputhje me Vendimin nr. 582, datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Procedurave Standarde të veprimit për Identifikimin dhe referimin e viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikimit".
- d) **Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit.**
- e) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".** Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.
- f) **Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.**
- g) **Për çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.**
- h) **Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë, nga klasa I deri IX,** çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.
- i) **Për tekstet shkollore të fëmijëve, nga klasa I deri IX, të cilët janë përfutues në institucionet e përkujdesit social rezidencial publik,** në Qendra Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të cituara më lart dhe dorëzojnë në Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.

**Objektiv 4, Sigurimi i një arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës më synim 100% e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin 9-vjeçar.** Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me AK. Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK. Ngritja dhe funksionimi pranë DAR/ZA i Komisioneve Multidisiplinare për fëmijët me AK.

### **Veprimtaritë sipas objektivit 4:**

- a) **Në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore,** në periudhën në periudhën 15 shkurt-15 mars 2017 u zhvilluan trajnime të mësuesëve, në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Korçë për përdorimin e Modullit Kurrikular për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky modul kurrikular është hartuar me mbështetjen e IOM dhe në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar për Antitrafikim. Në këto trajnime morën pjesë **195 mësues të lendeve Qytetari,** edukim për shoqërinë, histori, gjeografi, të cilët u pajisën edhe me Certifikate për trajnimin e kryer.
- b) Në vitin shkollor 2018, në arsimin bazë, numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara arriti në 620 mësues. Për vitin shkollor 2018-2019 është planifikuar rritja e mësuesëve ndihmës për fëmijët me AK rreth 950-1000 mësues ndihmës.
- c) MASR në bashkëpunim me Qendrën Psiko-sociale "Vatra" në periudhën Shkurt-Prill 2017 ka trajnuar **60 psikologë** dhe punonjës sociale të DAR Vlore, Fier dhe Berat si dhe ka zhvilluar fushatë ndërgjegjësimi me nxënësit e shkollave të mesme të DAR Vlore, Berat, Gjirokastrë, Fier për rrezikun e trafikimit dhe të shfrytëzimit të qenieve njerëzore.



- d) Në periudhën shkurt –mars 2018 janë plotësuar të dhënat për Romët dhe Egjiptianët. Për vitin shkollor 2018-2019 janë pajisur me tekste shkollore falas 3 500 nxënës romë dhe 5 5800 nxënës egjiptianë. Gjithashtu u sigurohet transport falas të gjithë fëmijëve e nxënësve romë dhe egjiptianë në kopshte e shkolla që udhëtojnë në largësinë mbi 2 km nga shtëpia.
- e) Janë miratuar fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet e bursave kuotë ushqimore për 350 nxënës romë dhe egjiptianë me afro 4.52 milion lekë në vit. Vendim nr. 132, datë 22.2.2017 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot për masat për nxitjen e të nxënësve, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2017-2018”.
- f) Janë parashikuar fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për institucionet special për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe nxënësit nuk shikojnë për rreth 220-240 nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë me afro janë plan Në kuadër të fushatës kombetare informuese me temë “Zgjidh mundësitë jo migracionin e parregullt”, MASR është bërë pjesë e grupit ndërsektorial të komunikimit, duke zhvilluar takime informuese me rreth 200 maturantë dhe ëorkshop-e me rreth 180 mësues të gjimnazeve, në periudhën tetor-dhjetor 2017, kjo fushatë ka vijuar dhe në vitin 2018. ifikuar 19.5 milion lekë.
- g) Janë parashikuar fonde buxhetore për shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, që punojnë me nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes 4-5 milion lekë;
- h) Janë parashikuar fonde buxhetore për shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, janë planifikuar 10-12 milion lekë, janë duke u realizuar me sukses procedurat e prokurimi.

### Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2018:

Realizimi i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2018 (Sesioni I dhe II).

- Hartimi i testeve për lëndët Gjuhë Shqipe, Gjuhë e Huaj dhe Matematikë (Sesioni I dhe II).
- Hartimi i fondit të pyetjeve të PKAB mbështetur në objektivat e programeve lëndore.
- Redaktimi i fondit të pyetjeve të PKAB.
- Hartimi i testeve të veçanta për nxënësit që nuk shikojnë.
- Hartimi i udhëzuesve për vlerësuesit e përgjigjeve të nxënësve për testet e PKAB, nëpërmjet të cilëve vlerësuesit orientohen për mënyrën e vlerësimit të nxënësve. Kjo për të bërë një vlerësim të standardizuar.
- Udhëzimet u janë dërguar në DAR-ZA.
- Hartimi i udhëzuesve për organizimin dhe administrimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë së bashku me tabelat përkatëse.
- Hartimi i tabelave të rezultateve të nxënësve në PKAB dhe udhëzuesit për plotësimin e tyre.
- Përgatiten skemat e vlerësimit dhe të pikëzimit dhe dërgohen në MASR dhe DAR-ZA.
- Përgatiten materialet për çdo DAR-ZA dhe trajnohen specialistët e DAR/ZA-ve për të gjithë procesin e PKAB.
- Studimi i të dhënave dhe PKAB 2018 dhe hartimi i raporteve publike dhe teknike.

Në mbyllje të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë, të dy sesionet, u krye analiza e rezultateve. Nëpërmjet “Raportit Publik” të publikuar nga QSHA, u bënë publike të dhënat e PKAB 2018 për institucionet qendrore dhe për publikun e gjerë, të interesuar për këto rezultate.

| PKAB 2018    | Nxënës gjithsej | Mbetës | Kalueshmëria | Nota mesatare |
|--------------|-----------------|--------|--------------|---------------|
| Gjuhë Shqipe | 39425           | 666    | 98.31%       | 7.47          |
| Matematikë   | 38728           | 310    | 99.20%       | 7.78          |
| Gjuhë e huaj | 42922           | 1073   | 97.50%       | 6.91          |

### Vlerësimi Ndërkombëtar PISA 2018:

- Përgatitja e të dhënave për realizimin e PISA 2018 (Prill 2018).
- Pjesëmarrja në trajnimet periodike vjetore të PISA 2018.
- Marrja në dorëzim e materialeve të reja për zhvillimin e testimit PISA CBA 2018
- Përkthimi dhe përshtatja e materialeve nëpërmjet dy softeve përkatëse OLT dhe QTA
- Miratimi i materialeve në Ëëstat, Capstan dhe ACER.
- Dërgimi pranë DIPF dhe ETS i materialeve të përkthyer dhe marrja e konfirmimit për saktësinë e tyre.
- Testimi i programit SDS (programi me të cilin u krye testimi i nxënësve)
- Testimi i programit KeyQuest (programi i kampionimit të të dhënave)
- Dërgimi i manualeve të përkthyer dhe marrja e versioneve përfundimtare nga OECD.
- Kampionimi i shkollave, nxënësve dhe mësuesve që u përfshinë në PISA 2018.
- Trajnimet e koordinatorëve, administratorëve të testit për PISA 2018.
- Përgatitja e materialeve për testim dhe shpërndarja nëpër shkolla.
- Përcaktimi i numrit të kompjuterëve të nevojshëm për realizimin e testimit.
- Marrja në dorëzim e kompjuterëve dhe testimi i tyre.
- Auditimi i çdo laboratorit TIK në shkollat e mesme të qytetit.
- Hartimi dhe zbatimi i një plani të detajuar për plotësimin e laboratorëve me kompjuter, me qëllim zhvillimin e testimit në afatet e përcaktuara.
- Shpërndarja e kompjuterëve në çdo qendër testimi.
- Hartimi i një kalendari të detajuar për zhvillimin e testimit në qendra testimi.
- Zhvillimi dhe monitorimi i tij.
- Marrja në dorëzim e materialeve të testimit dhe përgatitja e tyre për vlerësim.
- Përgatitja e sistemit për hedhjen e të dhënave, DME.
- Dërgimi i rezultateve duke plotësuar dhe raportet përkatëse.



### **Veprimtaritë që u realizuan:**

- plotësimi i të dhënave të pjesëmarrësve nëpërmjet formularit ST0, ST1, ST2.
- përkthimi dhe përshtatja e të gjitha materialeve.
- Implementimi dhe përpunimi i të dhënave të reja për formatin e ri të PISA 2018 CBA.
- Trajnimet përkatëse për ndryshimin e formatit të PISA nga Paper Based në Computer Based.
- Përgatitja e materialit udhëzues për nxënësit pjesëmarrës në PISA 2018.
- Përgatitja e materialeve informuese dhe sensibilizuese për çdo shkollë, si postera e materiale të tjera.
- Monitorimi i qendrave ku u zhvillua PISA, sipas kalendarit të zhvillimit të testimit, në të gjithë vendin.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve nga mësues të arsimit parauniversitar.
- Përgatitja e sistemit për hedhjen e të dhënave, DME.
- Dërgimi i rezultateve duke plotësuar dhe raportet përkatëse.
- Kthimi i përgjigjeve apo komenteve të pyetjeve nga PISA.

### **Vlerësimi Ndërkombëtar TIMSS 2019:**

- Përgatitja e të dhënave për realizimin e Field Trial për TIMSS 2019.
- Pjesëmarrja në trajnimet periodike vjetore.
- Përkthimi dhe përshtatja e materialeve.
- Përgatitja e databazës së shkollave dhe klasave të katërta për TIMSS

### **Veprimtaritë që u realizuan:**

- Përkthimi dhe përshtatja e të gjitha materialeve.
- Kampionimi i shkollave.
- Përgatitja e formave për mbledhjen e të dhënave të nxënësve dhe mësuesve.
- Përgatitja e materialit udhëzues (programi orientues, përkthimi i modeleve të pyetjeve që përdoren në TIMSS) për nxënësit pjesëmarrës në TIMSS.
- Formatimi dhe shumëfishimi i çdo instrumenti që do të përdorej në vlerësim.
- Monitorimi i qendrave ku u zhvillua TIMSS, në të gjithë vendin.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve nga mësues të arsimit parauniversitar.
- Përgatitja e sistemit për hedhjen e të dhënave në DME dhe EINE3S
- Dërgimi i rezultateve duke plotësuar dhe raportet përkatëse.
- Kthimi i përgjigjeve apo komenteve të pyetjeve nga IEA.

### **Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor (VANAF) 2018:**

- Realizimi i Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor.
- Hartimi i testit për lëndët Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre.
- Hartimi i fondit të pyetjeve mbështetur në objektivat e programeve lëndore.
- Redaktimi i fondit të pyetjeve.
- Hartimi i testeve të veçanta për nxënësit që nuk shikojnë.
- Hartimi i udhëzuesve për vlerësuesit e përgjigjeve të nxënësve për VANAF, nëpërmjet të cilëve vlerësuesit orientohen për mënyrën e vlerësimit të nxënësve. Kjo për të bërë një vlerësim të standardizuar.
- Udhëzimet u janë dërguar në DAR-ZA.
- Hartimi i udhëzuesve për organizimin dhe administrimin e VANAF së bashku me tabelat përkatëse.
- Hartimi i tabelave të rezultateve të nxënësve në VANAF dhe udhëzuesit për plotësimin e tyre.
- Përgatiten skemat e vlerësimit dhe të pikëzimit dhe dërgohen në MAS dhe DAR-ZA.
- Përgatiten materialet për çdo DAR-ZA dhe trajnohen specialistët e DAR/ZA-ve për të gjithë procesin e VANAF.
- Studimi i të dhënave të VANAF 2018 dhe hartimi i raporteve publike dhe teknike.

Në këtë testim për klasat e pesta u testuan të gjithë nxënësit e regjistruar në klasë të peste në vitin shkollor 2017-2018. Numri i nxënësve për testim ishte 32888 nxënës dhe numri i mungesave ishte 740. Nxënësit e përfshirë në testim ishin 32147.

Gjithashtu u krye rivlerësimi i përgjigjeve të nxënësve të klasës së pestë me qëllim matjen e objektivitetit të vlerësimit të kryer nga DAR/ZA. U rivlerësuan rreth 10% e testeve për çdo DAR/ZA. Në mbyllje të VANAF u krye analiza e rezultateve. Nëpërmjet "Raportit Publik" të publikuar nga QSHA, u bënë publike të dhënat e VANAF 2018 për institucionet qendrore dhe për publikun e gjerë, të interesuar për këto rezultate.

### **Realizimi i testimit për klasat kolektive (klasat 2 deri 9)**

- Përgatitja e testit dhe organizimi i testimit.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve.
- Përpunimi i rezultateve të testimit.
- Identifikimi për çdo DAR/ZA dhe për çdo shkollë i nxënësve të vlerësuar me notën 4, 5 dhe 6.
- Dërgimi i informacionit në DAR/ZA.

### **Veprimtaritë për realizimin e testimit të nxënësve të klasave kolektive:**

- Mbledhja e të dhënave në lidhje me shkollat dhe numrin e nxënësve që mësojnë në klasat kolektive.
- Hartimi i testeve mbështetur në kompetencat që duhet të zotërojnë nxënësi.
- Hartimi i testeve për lëndën e Gjuhës Shqipe për çdo klasë.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve.
- Informatizimi i të dhënave
- Studimi i të dhënave të testimit dhe hartimi i raportit publik.
- Evidentimi i treguesve të ndryshëm sipas klasave dhe sipas notave.

Numri i nxënësve pjesëmarrës në testim ishte **26654** nxënës. Në nivel kombëtar kalueshmëria në klasat kolektive është **89.73%**. Në mbyllje të testimit analiza e rezultateve. Nëpërmjet “Raportit të Arritjeve” të hartuar nga QSHA, u evidentuan tregues të ndryshëm sipas klasave dhe sipas notave.

#### **Realizimi i testimit për projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë”**

- Hartimi i testeve të gjuhës shqipe dhe matematikës për klasat 3, 5, dhe 8 në dy fazat.
- Hartimi i skemave të vlerësimit për testet e gjuhës shqipe dhe matematikës për klasat 3, 5, dhe 8, për të dyja fazat.
- Formatimi dhe shumëfishimi i testeve.
- Paketimi i testeve për çdo shkollë.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve nga mësues të arsimit parauniversitar.

Veprimtaritë për realizimin e testimit për projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë”:

- Mbledhja e të dhënave në lidhje me shkollat dhe numrin e nxënësve.
- Hartimi i testeve për lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës për klasat (3, 5 dhe 8).
- Formatimi dhe shumëfishimi i testeve.
- Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve.
- Informatizimi i të dhënave
- Numri i nxënësve pjesëmarrës në testim ishte **1900** nxënës.

#### **U hartua fondin e pyetjeve për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” 2018. (IZHA);**

**Portali “Mësues për Shqipërinë” është një risi në mënyrën e punësimit të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar.** Për vitin shkollor 2017-2018, ky proces ka filluar në nëntor 2017, periudhë në të cilën kandidatët kanë dorëzuar dosjen pranë DAR/ZA-ve. Ndërkohë gjatë muajit dhjetor 2017, u krye vlerësimi i dosjeve të kandidatëve nga DAR/ZA-të dhe u përgatitën databazat përkatëse. Gjithashtu, gjatë periudhës mars – prill 2018 është realizuar testi “Mësues për Shqipërinë, 2018”. Ky testim organizohet në mbështetje të udhëzimit nr. 40, datë 09.10.2018 “Për organizimin e testimit të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar”.

Veprimtaritë për realizimin e objektivit: Për realizimin e këtij objektivit sektori i kualifikimit dhe i karrierës, përmes specialistëve të tij përgjegjës dhe bashkëpunëtorëve të përzgjedhur për këtë qëllim, ka kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- janë koordinuar 24 grupe pune për hartimin e fondit të pyetjeve për testin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë”;
- u angazhuan 79 specialistë, mësues, pedagogë për hartimin e pyetjeve të fondeve lëndore;
- u bashkëpunua me specialistët e QSHA-së për përcaktimin e formatit të dorëzimit të fondit;
- u hartuan 24 fonde pyetjesh për 24 profile lëndore;
- u hartuan 6244 pyetje të niveleve të ndryshme, pjesë e 24 fondeve sipas profileve lëndore.

**Objektiv 5, Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e arsimit parashkollor dhe bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe mësuesve që punojnë e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre dhe mbulimi 100% i shpenzimeve të transporti me fonde të buxhetit.**

**Veprimtaritë sipas objektivit 5:** Për vitin 2018, vijon financimit të shërbimit të transportit në zbatimin e VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit". me një fond prej 620 milion lekë nga të ku përfitojnë shërbim transporti falas rreth 30-32 mijë nxënës që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe rreth 9 086 mësuesve që punojnë e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre **duke filluar nga viti 2015-2016 për herë të parë janë përfshirë në këtë skemë financimi dhe fëmijët të arsimit parashkollor si dhe edukatorët e kopshteve**. Nga të cilat rreth 307 milion leke përfitohen nga 9 086 punonjësit mësimorë dhe 313 milion leke nga 30-32 mijë nxënës dhe fëmijë në të gjithë vendin.

- a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;”.
- b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht); Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).
- c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);
- d) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.

**Objektiv 6, Konsolidimi i shërbimit psiko-social nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të njësisë së shërbimit psiko-social në njësitë arsimore vendore.** Trajnimi i vazhdueshëm i psikologëve (150) dhe punonjësve socialë (150). Ngritja e mekanizmit të supervizimit të shërbimit psiko-social dhe e kapaciteteve të tyre. Modernizimi i kabineteve të shërbimit psiko-

social (kompjuter, printer, telefon) dhe pajisja me instrumentet e punes (teste vlerësimi, dosje individuale për çdo nxënës, manuale pune)**Veprimtaritë sipas objektivit 6:**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe Bashkimin Europian kanë filluar zbatimin e projektit “**Të luftojmë bulizmin dhe ekstremizmin në sistemin arsimor shqiptar**”. Këshilli i Europës, përmes këtij projekti, synon mbështetjen për vlerësimin e mbrojtjes së të drejtave të grupeve vulnerabël, duke aplikuar qasje antidiskriminuese në sistemin arsimor në Shqipëri, duke u mbështetur në standardet dhe praktikën e Këshillit të Europës. Projekti është prezantuar në Shqipëri më 3 nëntor 2016. Pas realizimit të studimit kombëtar mbi këtë fenomen, janë përcaktuar 21 shkolla pilot në të cilat kanë filluar zbatimin e këtij projekti. **Në vitin 2017-2018 u realizua:**

- Përgatitja e programit/Modulin Njëvjeçar të mbështetjes në shkolla për projektin e BE/KiE ‘Lufta kundër bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri’ ;
- U hartua paketa burimore për mësuesit dhe stafin shkollor
- Tre fokus grupe për diskutimin e gjetjeve të raportit
- Tryeze e rumbullaket për prezantimin e gjetjeve finale nga vrojtimi kombëtar mbi bulimin dhe ekstremizmin në sistemin arsimor në Shqipëri si dhe takimi prezantues me 21 shkollat pilot– Tirane
- U organizua Konferenca ndërkombëtare mbi bullizmin dhe ekstremizmin –
- U realizua trajnimi i koordinatorëve dhe 10 mësuesve për çdo shkollë shkollë të cilët do të jenë pjesë e organizimit të projekti.
- U realizuan ditët e hapura për ndërgjegjësimin për luftën kundër bulizmit në sistemin arsimor shqiptar.
- Janë realizuar dy takime të Komitetit Drejtues të projektit.

- a) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është pjesë e Task forcës ndër institucionale në zbatim të VKM nr. 248, datë 29.03.2017 për Miratimin e **planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020**. Gjithashtu për zbatimin e Miratimit të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.270, datë 17.05.2017 u ngrit task forca institucionale që do të planifikojë zbatimin e planit në praktike. IZHA po realizon ndryshimet kurrikul përmes analizës së shkallës së përfshirjes në kurrikulat e arsimit parauniversitar të çështjeve që lidhen me edukimin kundër drogave. Hartimi i pyetësorëve dhe anketimi i nxënësve mësuesve dhe prindërve për problemet e shmangies së drogës në shkollë; Hartimi i moduleve kurrikulare për lëndët: biologji, qytetari, edukim fizik sporte dhe shëndet për arsimin bazë dhe të mesëm me fokus edukimin kundër drogave; DAR/ZA- të kanë ngritur, kanë ngritur task forcën në nivel DAR/ZA-je dhe shkollë dhe kanë hartuar plane të luftës kundër drogës në shkolla. MASR ka qenë pjesë e trajnimeve TAIEX për përgatitjen e planit të veprimit për luftën kundër kanabisit.
- b) Forcimi i nismës “**Shkolla qendër komunitare**”. Në vitin shkollor 2017-2018 kemi 270 shkolla qendra komunitare, 96 398 nxënës dhe 2820 mësues të përfshirë. SHQK mbështetet mbi standardet e miratuara nga MASR. Ajo është e koordinuar në të gjitha nivelet. Nisma vijon të mbështetet nga partnerë të MASR si Këshilli Europë, UNICEF, Korpusi Paqes, Eorld Vision, Save the Children, etj. .
- c) Mbështetur mbi raportin e **mbi situatën në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë në Shqipëri** me rekomandime për përmirësimin e të mësuarit dhe kurrikulës, grupi i punës propozoi hartimin e një marrëveshje të re midis MASR, MSHMS, MF dhe ANAD si dhe një plan veprimi për periudhën 2017-2019. Institucionet kanë realizuar disa takime për të përcaktuar detyrimet.

**Objektiv 7, Arsimi cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane: ndërtime të reja, pershtatje të godinave ekzistuese shkollore për përfshirjen e femijeve me AK, rehabilitim të objekteve arsimore 550-600 klasa e sigurimi i pajisjes së tyre. Pajisja e 20-25% të shkollave të AB me laborator shkencorë, IT synimi një kompjuter për dy nxënës në orë mësimi, laboratorë virtual e biblioteka dixhitale në AB (të paktën 4 set laptop-projektor për çdo tre shkolla IT: shtimi i laboratoreve virtuale në arsimin bazë me të paktën 1 set laptop projektor në 500 shkolla, trajnimi i 1200 mësuesve për përdorimin e sistemit elearning dhe krijimin e content-it digjital, modernizimi i sistemit të shërbimeve online të ofruara në arsimin bazë. **Veprimtaritë sipas objektivit 7:****

#### **Fonde për shpenzime kapitale për vitin 2018 në arsimin bazë.**

Fondet për shpenzim kapitale investime janë miratuar në masën **1 miliard e 757 milion lekë ose rreth 58.2%** e fondeve të planifikuara në buxhetin për vitin 2018. Fondet e rishikuara me aktet normative të muajit Korrik dhe dhjetor 2018 kanë ndryshuar fondet me burim financimin e brendshëm dhe financimin e huaj që arrijnë **në 1 miliard e 694 milion lekë**, ose 9 % e fonde të miratuara për ministrinë e arsimit. Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- muajin 2018 ndaj fondeve të parashikuara **për 12-mujorin 2018 është në masën 1 miliard 603 milion lekë ose në masën 95%**, ndaj planit të rishikuar të investimeve dhe në masën 7.3 % ndaj totalit të shpenzimeve për vitin 2018.

- a) **Në programin e arsimit bazë për arsimin për vitin 2018** me vendimin nr.7, datë 11.5.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “*Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja për vitin 2018-2019, grandet “Arsimi”*”, janë miratuar 30 projekte në arsimin bazë me vlerë financimin për vitin 2018-2019, me vlerë të plotë të projektit në shumën 2.1 miliard lekë, nga të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore do të financojnë shumën 364 milion lekë ose 10-30% të vlerës së projektit të miratuar, fonde të miratuara për vitin 2018 pjesë e fondeve të arsimit janë në shumën 662 milion lekë dhe fonde të parashikuara me prioritet për vitin 2019 janë në shumën 983.3 milion lekë.

**Për "ndertimi i shkollave/kopshteve te reja",** gjatë vitit 2018 u planifikuan 430.7 milion lekë , fondet e rishikuara ishin në masën 389.5 milion lekë dhe realizuan punimet në 85 klasa masimore në shumën 384.1 milion lekë ose në masën 99%, e fondeve të rishikuara për vitin 2018.

**Për "rindërtimi/rikostruksionin e ndërtesave egzistuese",** gjatë vitit 2018 u planifikuan 1 miliard 187.2 milion lekë , fondet e rishikuara ishin në masën 1 miliard e 172.2 milion lekë dhe realizuan punimet në 310 klasa masimore në shumën 1 miliard e 97.7 milion lekë ose në masën 94%, e fondeve të rishikuara për vitin 2018.

- b) **Furnizimi me orendi e pajisje mobilierie** për 90-100 institucione arsimore/ shkollat të arsimit para universitar për vitin 2018, **me një fond prej 60 milion lekë, realizimi në masën 60 milion lekë ose 100%,** ku përfitues janë **162 klasat mësimore,** laboratorët dhe kabinetet / objektet e institucioneve që kanë përfunduar ndërtimin apo rehabilitimin, si dhe institucione të arsimit parashkollor, cilat kanë pasur mungesa apo pajisje të amortizuara tërësisht dhe që kanë nevojë emergjente për rinovim.
- c) **Furnizimi dhe pajisjen me pajisje laboratorë mësimorë didaktikë** për programet Fizike \_Kimi\_+Biologji për vitin 2018, me një fond prej 40 milion lekë, realizimi në masën 38.4 milion lekë ose 96%, ku përfitues janë për 53 institucione arsimore/ shkollat të arsimit parauniversitar, ku institucione të kanë pasur mungesa apo pajisje të amortizuara tërësisht dhe që kanë nevojë emergjente për rinovim.
- d) **Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm,** në 5 institucione arsimore vendore për 20 shkollat të arsimit parauniversitar për vitin 2018, me një fond prej 10 milion lekë, realizimi në masën 1.23 milion lekë ose 12.3%, institucionet nuk kanë arritur të prokurojnë me sukses.

### **Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12- mujorin 2018:**

1. Vonesa në shpalljen e thirrjeve dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për fondet e zhvillimit të rajoneve 2018, për projektet e reja për vitin 2018, Vendimi i Komitetit për Zhvillimit të Rajoneve Nr.7 datë 11.5. 2018 në shumën prej 1.5 miliard lekë për projektet e reja për vitin 2018.
2. Moszbatimi i grafikut të punimeve për objektet/kontratat nga autoriteti kontraktor në vijim nga viti 2017-2018, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kontraktorët e punimeve për 8-mujorin e parë Janar- Gusht 2018.
3. Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2018, si dhe lidhja e kontratave është realizuara 12-mujorin e parë 2018, me ndikim dhe risk të lartë në realizimin e fondeve për vitin 2018.

### **III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230);**

Programi synon krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, e bashkëkohor; mirë menaxhim të burimeve njerëzore; fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore; shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm; për rritjen e nivelit të arsimit të popullsisë, për ta përafuar atë me standardet evropiane dhe për të përgatitur qytetarë më të aftë për një shoqëri demokratike. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Hartimi dhe zbatimi i kurrikules së re në arsimin e mesëm. Mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve. Promovimi dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore në institucionet shkollore të arsimit të mesëm.

#### **Objektivat kryesore:**

**Objektiv 1).** Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijnë në 95-97% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë.

**Objektiv 2).** Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve të klases së 11 në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.

**Objektiv 3).** Realizimi i Maturës Shtetërore 2018, realizimi i testimit "Mësues për Shqipëri", në formë elektronikë

**Objektiv 4).** Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm (rehabilitimi i 9% të klasave në gjimnazeve në zonat urbane, shtimi me 5%-8% i klasave të reja në zonat urbane, pajisja me mjete didaktike për Fizikë-Kimi-Biologji për 8% në vit të shkollave të mesme, pajisja i klasave/shkollave me klasa mësimore inteligjente/ digjitale, si dhe pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat me 10% të fondit ekzistues të bibliotekave).

#### **Buxheti i miratuar për programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2018,**

**Buxheti i miratuar për programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2018,** është në vlerën 7 miliard e 94 milion lekë me 16.6% të buxhetit të MASR. Fondet e buxhetit të rishikuar për vitin 2018 arrijnë në vlerën 6 miliard e 969.7 milion lekë me 18.2% të buxhetit të MASR, së bashku me të ardhurat e përdorura arrijnë në 6 miliard e 969.7 milion lekë.

**Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018** është në masën 6 miliard 855 milion lekë ose në 98% e fondeve të parashikuara për 12-mujorin e parë 2018.

**Fondet e arsimit të mesëm** zënë rreth 16.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore 2018, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe 1.38% ndaj shpenzimeve publike dhe 0.42% ndaj PBB%.

- a) **Fondet për shpenzime personeli ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore, janë 5 miliard e 849 milion lekë**, buxheti i rishikuar aariti në shumën prej 5 miliard e 772 milion lekë. Fondet e realizuara në shpenzime personeli për vitin 2018 arritën në shumën 5 miliard e 713 milion lekë ose 99% e fondeve të planifikuara.

Në këtë program janë mbuluar shpenzimet e personelit për afro 6 574 punonjës mësimore në institucione arsimore ku përfitues të shërbimit arsimor janë rreth **104 308** nxënës ve në arsimin e mesëm (gjimnazet), realizimi 12-mujor është në masën **5 miliard e 713 milion lekë ose në masën 99% e planit vjetor 2018.**

**Për vitin 2018 në programin e arsimit të mesëm, u siguruan kushtë për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 300 praktikantë konform** Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e numrit të praktikantëve “Për kryerjen e praktikës profesionale” me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar deri 15 qershor 2018 dhe 15 shtator deri 31 dhjetor 2018, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.

Konform rregullores mbi “Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit” Nr. 3874, datë 14.07.2011 **miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit** si dhe **programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj**, të cilët do t’i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, mësuesit e diplomuar në shkollat tona të larta do të mundën ta ushtrorjnë profesionin e mësuesit vetëm pasi t’i nënshtrohen praktikës profesionale njëvjeçare të cilët janë mësues që përmbushin kriteret të caktuara, dhe pasi t’i jenë nënshtuar provimit të shtetit.

**Për vitin 2018 punonjësit e arsimit parauniversitar** kanë përfituar shpërbim nga fondi i vecantë rreth 14 milion lekë, për rastet e daljes në pension, raste hospitalore si dhe për rastet e ndarjes nga jeta të pjestarëve të familjes.

- b) **Shpenzime operative** në artikullin **602- 606, janë planifikuar 223.1 milion lekë ose 3.5%** e shpenzimeve korente, buxhti i rishikuar së bashku me fonde të çelura për detyrime borxhe është në masën 311.3 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për periudhën 12- mujore është në masën **300 milion lekë** ose 97% ku përfshihen.
- Shpenzime për transportin e mësuesve në vlerën **50 milion lekë**, janë realizuar 50 milion lekë realizimi është në masën 100%;
  - Shpenzime për blerje mjetet didaktike e materiale të tjera mësimore në vlerën **50 milion lekë realizimi është në masën 100%**,
  - Shpenzime për trajnime personeli e të ngjashme udhëtime e dieta personeli – **20 milion lekë realizuar 100%**,
  - Shpenzime për AKP - **50 milion lekë**, shpenzime për aktivitete të maturës shtetërore 2018, si dhe provimet e shteti realizimi në masën 100%.
  - Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor regjista, amza, deftesa, **2 milion lekë.**
  - Shpenzime për të mbuluar aktivitetë ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MASR, **2 milion lekë realizimi në masën 100%**

**Shpenzime për në artikullin 606** - Ndërsa për nxënësit e arsimit të mesëm gjimnazet kanë përfituar 15 333 nxënës me një fond prej 98.2 milion lekë.

**Investimet Fondet për investime kapitale në programin e Arsimit Mesëm të Përgjithshëm** me objektiv sigurimin dhe përmirësimin e kushteve të infrastrukturës në mjediset e sistemit para universitar, shmangien dhe reduktimin e zhvillimit të mësimin me turne, reduktimin e numrit të nxënësve për klase, me synim realizimin që të gjithë shkollat në zonat urbane të qyteteve kryesore të vendit të arrihet raporti 30 nxënës/klasë.

Për vitin 2018 janë **miratuar 1 miliard e 22 milion lekë, me burim financim të brendshëm 100%**. Buxheti i rishikuar për këtë program është 876.2 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- mujorin 2018 në këtë program është 831.7 milion lekë ose 95% e planit 12-mujor 2018, sipas projekteve kryesore paraqiten:

- a) **Për projektet rikonstruksione dhe shtesa të objekteve arsimore në vitin 2018**, janë miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për **26 projekte/ objekte** me vlerë të plotë të kontratës 1 miliard e 640 milion lekë dhe financim për vitin 2018 në shumën 726.2 milion lekë dhe realizimi në shumën 712.7 milion lekë ose 98.1%.
- b) **Janë financuar për blerje pajisje mobilierie për objekte arsimore** që përfundojnë punimet në vitin 2018, shuma prej **60 milion lekë** kontrata e prokuruar dhe realizuar për pajisjen shkollave të arsimit para universitar, për objekte/ shkolla të cilat kanë pasur mungesa apo pajisje të amortizuara tërësisht dhe që kanë nevojë emergjentë për rinovim, kjo kontratë është realizuar sipas grafikut të parshikuar në procedurat e prokurimit në shumën 59.7 milion lekë ose në masën 100% e fondit të parashikuar për vitin 2018. Duke pajisur me pajisje mobilierie rreth 165 klasa dhe laboratorë mësimore.
- c) **Janë financuar 30 milion lekë për pajisje laboratorit Fizikë\_Kimi\_Biollogji** për afro 40 institucione arsimore, në objektet arsimore që përfundojnë punimet në vitin 2018 kontrata është 100%. Ky projekt është realizuar në masën 28.6 milion lekë duke furnizuar me pajisje laboratorit Fizikë\_Kimi\_Biollogji për afro 40 institucione arsimore.
- d) **Bashkëfinancim për projektet me financim të huaj** për vitin 2018, plani vjetor është 50 milion lekë TVSH, janë realizuar vetëm pagesa në formë indirekte në shumën 29.6 milion lekë pagesë TVSH për bashkëfinancim në ndërtim i shkolles 9-vjeçare dhe e mesme "MONS LUCIA AGUSTI", VAU I DEJES, SHKODER, si dhe TVSH- Për projektin



- e) **Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm**, në 6 institucione arsimore vendore për 20 shkollat të arsimit parauniversitar për vitin 2018, me një fond prej 10 milion lekë, realizimi në masën 1.2 milion lekë ose 13.5%, institucionet nuk kanë arritur të prokurojnë me sukses.


**Sipas grup artikujve të dhënat janë sa vijon;**

|                            |            |
|----------------------------|------------|
| <i>Shpenzimet korentë</i>  | <b>99%</b> |
| <i>Shpenzimet kapitale</i> | <b>95%</b> |
| <b>Gjithsej</b>            | <b>98%</b> |

Fondet e realizuara në vitin 2016-2017 si dhe fondet e miratuara dhe të realizuara për vitin 2018;

| ANEKSI Nr.2   |   |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
|---|---|---------------------|---------------------|--------------------|--------------------|------------------------|---------------------------------|---------------------|--|-------------|
| mit sipas Artikujve per Buxheti 2018 (cdo 4 mujor progresive) |   |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
|   |   | ne 000 leke         |                     | 12 mujori 2018     |                    | ne 000 leke            |                                 |                     |  |             |
| Ministria   | MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     | Kodi                                   | 11          |
| Programi  | Arsimi I Mesem I Pergjithshem           |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     | Titulli                                | 09230       |
| Totali Shpenzimeve  |   |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
| Artikulli   | 0                                       | 1                   | 2                   | 3                  | 4                  | 5                      | 6                               | (7)=(6)-(5)         | Realizime % ndaj planit 12- mujor 2018 |             |
| Kodi  | Buri                                    | Fakti 12-mujor 2016 | Fakti 12 mujor 2017 | PBA 2018           | Buxheti 2018       | Buxheti rishikuar 2018 | Buxheti periodhes 12 mujor 2018 | Fakti 12 mujor 2018 | Diferenca 2018                         |             |
| 600   | Paga                                    | 4,688,589.0         | 4,892,876.3         | 4,361,850.0        | 4,986,850.0        | 4,922,759.9            | 4,922,759.9                     | 4,882,987.2         | 39,772.6                               | 99%         |
| 601   | Sigurime Shoqërore                      | 779,199.6           | 827,452.1           | 757,667.0          | 862,667.0          | 849,397.0              | 849,397.0                       | 830,782.1           | 18,614.9                               | 98%         |
| 602   | Mallra dhe Shërbime të Tjera            | 169,908.9           | 130,010.1           | 153,082.0          | 153,100.0          | 201,090.7              | 201,090.7                       | 195,267.8           | 5,823.0                                | 97%         |
| 603   | Subvencione                             |                     |                     | 0.0                | 0.0                |                        |                                 | 0.0                 | 0.0                                    |             |
| 604   | Transferta Korente të Brendshme         |                     |                     | 0.0                | 0.0                |                        |                                 | 0.0                 | 0.0                                    |             |
| 605   | Transferta Korente të Huaja             |                     | 23,614.5            | 0.0                | 0.0                |                        |                                 | 0.0                 | 0.0                                    |             |
| 606   | Trans per Bush. Fam. & Individ          | 91,361.0            | 89,144.5            | 70,000.0           | 70,000.0           | 110,235.0              | 110,235.0                       | 104,652.5           | 5,582.5                                | 94.9%       |
| <b>Nen-Totali</b>   | <b>Shpenzime Korrente</b>               | <b>5,729,058.4</b>  | <b>5,963,097.4</b>  | <b>5,342,599.0</b> | <b>6,072,617.0</b> | <b>6,083,482.6</b>     | <b>6,083,482.6</b>              | <b>6,013,689.7</b>  | <b>69,792.9</b>                        | <b>99%</b>  |
| 230   | Kapitale të Patrëpëzuara                | 0.0                 | 0.0                 | 0.0                | 0.0                |                        |                                 | 0.0                 | 0.0                                    |             |
| 231   | Kapitale të Trupëzuara                  | 707,409.4           | 691,846.4           | 850,673.0          | 1,022,115.0        | 876,191.0              | 876,191.0                       | 831,714.2           | 44,476.8                               | 95%         |
| 232   | Transferta kapitale                     |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
| <b>Nen -Totali</b>  | <b>Shpenzime Kapitale fin Brendshem</b> | <b>707,409.4</b>    | <b>691,846.4</b>    | <b>850,673.0</b>   | <b>1,022,115.0</b> | <b>876,191.0</b>       | <b>876,191.0</b>                | <b>831,714.2</b>    | <b>44,476.8</b>                        | <b>95%</b>  |
| 230   | Kapitale të Patrëpëzuara                |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
| 231   | Kapitale të Trupëzuara                  | 135,268.0           | 33,312.4            |                    |                    | 0.0                    |                                 |                     |  |             |
| 232   | Transferta kapitale                     |                     |                     |                    |                    |                        |                                 |                     |  |             |
| <b>Nen -Totali</b>  | <b>Shpenzime Kapitale fin Huaj</b>      | <b>135,268.0</b>    | <b>33,312.4</b>     | <b>0.0</b>         | <b>0.0</b>         | <b>0.0</b>             | <b>0.0</b>                      | <b>0.0</b>          | <b>0.0</b>                             | <b>0.0</b>  |
| <b>Totali</b>   | <b>Korrente dhe Kapitale</b>            | <b>6,571,735.7</b>  | <b>6,688,256.1</b>  | <b>6,193,272.0</b> | <b>7,094,732.0</b> | <b>6,959,673.6</b>     | <b>6,959,673.6</b>              | <b>6,845,403.9</b>  | <b>114,269.7</b>                       | <b>98%</b>  |
| <b>shete Buxhetore</b>  |   | <b>2,569.2</b>      | <b>9,444.4</b>      | <b>0.0</b>         | <b>0.0</b>         | <b>10,051.5</b>        | <b>10,051.5</b>                 | <b>10,051.5</b>     | <b>0.0</b>                             | <b>100%</b> |
| <b>97,093</b>   | Nr. 97093 nxenes =97093 nxenes ne AM    | <b>67.7</b>         | <b>69.0</b>         |                    | kosto nxenes       | kosto nxenes           | kosto nxenes                    |                     | 70.6                                   |             |
| <b>Totali (korrente + kapitale + jas)</b>                     |   | <b>6,574,305</b>    | <b>6,697,700</b>    | <b>6,193,272</b>   | <b>7,094,732</b>   | <b>6,969,725</b>       | <b>6,969,725</b>                | <b>6,855,455</b>    | <b>114,270</b>                         | <b>98%</b>  |
| P B B sipas   |   | 0.45%               | 0.43%               | 0.38%              | 0.43%              | 0.42%                  | 0.42%                           | 0.42%               | 0.01%                                  |             |
| shpenzimet Totale te konsoliduara ne m                        |   | 1.52%               | 1.45%               | 1.25%              | 1.43%              | 1.40%                  | 1.40%                           | 1.38%               | 0.02%                                  |             |

| Arsimi I Mesem I Pergjithshem                   |                    |
|---|--------------------|
| Buxheti I rishikuar per vitin 2018 ne mijë lekë |                    |
| Pagat e punonjeseve                             | 4,922,759.9        |
| Sigurime Shoqërore                              | 849,397.0          |
| Mallra dhe Shërbime të Tjera                    | 201,090.7          |
| Subvencione                                     | 0.0                |
| Transferta Korente të Brendshme                 | 0.0                |
| Transferta Korente të Huaja                     | 0.0                |
| Trans per Bush. Fam. & Individ                  | 110,235.0          |
| Kapitale të Patrëpëzuara                        | 0.0                |
| Kapitale të Trupëzuara                          | 876,191.0          |
| <b>Totali</b>                                   | <b>6,959,673.6</b> |



**Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara për 12- mujorin 2018:**

- Vonesa në shpalljen e thirrjeve dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për fondet e zhvillimit të rajoneve 2018, për projektet e reja për vitin 2018, Vendimi i Komitetit për Zhvillimit të Rajoneve Nr.7 datë 11.5.2018 në shumën prej 1.5 miliard lekë për projektet e reja për vitin 2018.
- Moszbatimi i grafikut të punimeve për objektet/kontratat nga autoriteti kontraktor në vijim nga viti 2017-2018, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kontraktorët e punimeve për 8-mujorin e parë Janar- Gusht 2018.
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2018, si dhe lidhja e kontratave është realizuara 12-mujorin e parë 2018, me ndikim dhe risk të lartë në realizimin e fondeve për vitin 2018.

**Arritje 2018 : Veprimtaritë sipas objektivit 1**

- Në vitin shkollor 2016/2017, rreth 96% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar u regjistruan në arsimin e mesëm, sipas të cilit çdo nxënës që përfundon arsimin e detyruar duhet të ketë mundësi reale për të vijuar arsimin e mesëm, është realist dhe në rrugë të mbarë të realizimit të tij. Për vitin 2017-2018 në **arsimin e mesëm** u siguruan kushte dhe shërbim arsimor për rreth **127,118 nxënës** të rregjistruar në arsimin e mesëm nga të cilët **99 457** dhe për vitin akademik 2017-2018 rreth **120,062 nxënës në arsimin e mesëm** nga të cilët 99,457 nxënës vijuan arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe 20,605 nxënës në arsimin profesional.
- Në vitin shkollor 2017-2018, afro 96,6% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm. Në këtë vit shkollor marrin shërbim arsimor në arsimin e mesëm 120,062 nxënës, respektivisht 20,605 në arsimin e mesëm profesional dhe 99,457 vijojnë gjimnazin dhe arsimin e mesëm të orientuar.

**Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe Përqindjet përkatëse sipas Niveleve të Arsimit 2017-2018**

|                           | Gjithsej në Arsimin Parauniversitar | Arsimi Parashkollor (AP) | Përqindja Nx. AP / Gjithsej | Arsimi Bazë (AB) | Përqindja Nx. AB / Gjithsej | Arsimi i Mesëm (AM) | Përqindja Nx. AM / Gjithsej | Arsimi mesem profesional | Përqindja Nx. AM prof/ Gjithsej |
|---------------------------|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|---------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------------------|
| <b>Nr. i Nxënësve</b>     | 520,759                             | <b>81,026</b>            | 15.56%                      | <b>319,671</b>   | 61.39%                      | <b>99,457</b>       | 19.10%                      | <b>20,605</b>            | 3.96%                           |
| <b>Nr. Institucioneve</b> | 3,484                               | 1,919                    | 50.51%                      | 1,345            | 35.40%                      | 454                 | 11.95%                      | 41                       | 1.18%                           |
| <b>Nr. i Mësuesve</b>     | 38,471                              | 4,740                    | 12.32%                      | 24,790           | 64.44%                      | 7,687               | 19.98%                      | 1,254                    | 3.26%                           |

**Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe % sipas Niveleve të Arsimit (Arsimi Publik dhe Privat) Viti Shkollor 2016-2017**

|  | Gjithsej në | Arsimi | Përqindja | Arsimi | Përqindja | Arsimi i | Përqindja | Arsimi | Përqindja |
|--|-------------|--------|-----------|--------|-----------|----------|-----------|--------|-----------|
|--|-------------|--------|-----------|--------|-----------|----------|-----------|--------|-----------|

|                 | Arsimin Parauniversitar | Parashkollor (AP) | Nx. AP / Gjithsej | Bazë (AB) | Nx. AB / Gjithsej | Mesëm (AM) | Nx. AM / Gjithsej | mesem profesional | Nx. AM prof/ Gjithsej |
|-----------------|-------------------------|-------------------|-------------------|-----------|-------------------|------------|-------------------|-------------------|-----------------------|
| Nr. i Nxënësve  | 542,818                 | 87,600            | 16%               | 328,100   | 60%               | 106,137    | 20%               | 20,981            | 4%                    |
| Nr. Institucion | 3,807                   | 2,221             | 58%               | 1,370     | 36%               | 451        | 12%               | 45                | 1%                    |
| Nr. i Mësuesve  | 39,018                  | 5,110             | 13%               | 24,866    | 64%               | 7,765      | 20%               | 1,277             | 3%                    |

## Të plotësojë paketën kurrikulare sipas qasjes me kompetencat në arsimin e mesëm të lartë, me udhëzues kurrikularë lëndorë.

Plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin e mesëm të lartë ka të bëjë me hartimin e udhëzuesve kurrikularë lëndorë. Këta udhëzues janë hartuar sipas profileve lëndore në ndihmë të mësuesve të arsimit të mesëm të lartë me shembuj konkretë dhe praktikë për zbatimin e kurikulës në klasat 10-12. Udhëzuesit kanë në fokus zbatimin e metodave dhe të teknikave për zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave lëndore, vlerësimin për të nxënë, vlerësimin e të nxënësve, vlerësimin e portofolit, hapat e hartimit të testeve me kompetenca etj. **Veprimtaritë për realizimin e objektivit:** Për realizimin e këtij objektivit sektori i zhvillimit të kurikulës dhe të standardeve, përmes specialistëve përgjegjës për secilin udhëzues dhe bashkëpunëtorëve të përzgjedhur për këtë qëllim, kanë kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- janë ngritur 12 grupe pune me specialistë të IZHA-s, bashkëpunëtorë, mësues sipas profileve për arsimin e mesëm të lartë;
- u diskutua dhe u përcaktua struktura e udhëzuesit;
- u hartuan draftet e para të 12 udhëzuesve;
- u prezantuan dhe u diskutuan ndërmjet specialistëve dhe mësuesve në tryeza të rumbullakëta të gjitha draftet e udhëzuesve;
- ka përfunduar hartimi i 12 udhëzuesve lëndorë të arsimit të mesëm të lartë, klasat 10-12: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, TIK, muzikë, art pamor, edukim fizik;
- është në proces hartimi i udhëzuesit të profilit të shkencave sociale;
- janë publikuar në faqen e IZHA-s 12 udhëzuesit lëndorë të arsimit të mesëm të lartë, klasat 10-12.

## Kualifikimin e mësuesve për vitin 2018.

Kualifikimi i mësuesve organizohet në mbështetje udhëzimit nr. 2, datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. Kualifikimi i mësuesve organizohet për mësuesit që plotësojnë vjetërsinë 5, 10 dhe 20 vjet punë duke përfituar shkallët e kualifikimit respektive: shkalla III (mësues i kualifikuar), shkalla II (mësues specialist) dhe shkalla I (mësues mjeshtër). Kualifikimi 2018 është viti i njëmbëdhjetë që mësuesit dhe drejtuesit e arsimit parauniversitar i nënshtrohen testimit për të marrë kategoritë e kualifikimit. Në procesin e kualifikimit për vitin 2018, morën pjesë 2950 mësues të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm. Testimi u zhvillua në datë 21.04.2018.

1. **Ka filluar përgatitja për pjesëmarrje të Shqipërisë në PISA 2018.** Për këtë, janë përzgjedhur shkollat, janë përshtatur pyetësorët, përkthyer testet dhe manualët. Po përgatitet database për nxënësit pjesëmarrës në pilotim. Për herë të parë PISA do të zhvillohet në modelin computer based assesment. Gjate muajit Prill 2017 ne 32 shkolla te 17 DARZA, u zhvillua pilotimi i PISA 2018, me pjesëmarrjen e 2147 nxenesve 15 vjecare. PISA 2018 do te zhvillohet ne formatin computer based dhe pilotimi ishte po ne kete format.
2. **Nisma mbështetet mbi standarde të miratuara nga MASR.** Ajo është e koordinuar në të gjitha nivelet. Nisma mbështetet nga institucione dhe organizata , partnerë të MASR në këtë nismë si Këshilli Europës, UNICEF, Korpusi Paqes, Eorld Vision, Fondi shqiptaro-amerikan për zhvillim, Save the Children, Këshilli Britanik, Terre Des Homme etj. DAR/ZA dhe shkollat pjesë të kësaj nisme per vitin shkollor 2013-2014 realizuan: Veprimtari në kuadrin e gjithëpërfshirjes në arsim, me komunitetin rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim psikologjik. Veprimtari sportive të gjitha llojeve të sporteve ne mjediset aktuale por dhe ne veprimtari rajonale apo tëpushtetit vendor.Veprimtari kulturore, artistike. Bibliotekat ne funksion të të gjithëve Veprimtari për mbrojtjen e mjedisit. Në këto veprimtari janë përfshirë një numër i konsiderueshëm nxënësish, mësuesish dhe prindërit.
3. Në vitin shkollor 2017-2018 u zgjerua numri i shkollave të përfshira në iniciativën Shkolla Qendra Komunitare, sot kemi 162 shkolla nga 150 të synuara si rezultat i rishikimit të hartës shkollore pjesëmarrëse në këtë nismë. Numri i shkollave është rritur përafërsisht në çdo DAR/ZA rreth 11 shkolla në total.

## Veprimtaritë sipas objektivit 2;

1. Në vitin 2015-2016 filloi implementimi i kurikulës së re në kl 10 të gjimnazit. Në vitin 2016-2017 implementimi i kurikulës së re në klasën e 11-të. Vijon hartimi i programeve të klasës së 12-të (lëndët bërthamë dhe me zgjedhje të detyruar). **(Vazhdon në proces).**
2. U hartuan 13 module për trajnimin e mësuesve të shkollave pilot, u organizuar trajnimi i mësuesve për 26 shkolla pilot në 13 DAR ku u trajnuan 3797 mesues të klasës 11.

3. Në mars 2017 u trajnuan 1302 drejtorë shkollash, në të gjitha DAR/ZA-të, për Standardet e performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave. U realizua testimi sipas portalit "Mësues për Shqipërinë", Janar 2017. U publikua për çdo DAR renditja e mësuesve sipas vlerësimit në testim dhe nëpërmjet dosjeve personale të dorëzuara në DAR.
4. **Gjatë periudhës mars-prill 2017** MASR zhvilloi procesin për përzgjedhjen e teksteve të reja shkollore për klasat III, VIII dhe XI sipas kurrikulës së re. Gjithashtu vijon puna për mbledhjen e mendimeve të mësuesve për tekstet e reja që po pilotohen në klasat II, VII dhe X.
5. **Janë financuar 50 milion lekë për pajisje mobilierie** për objektet arsimore që përfundojnë punimet në vitin 2017 procedura e prokurimit është duke u realizuar për pajisjen shkollave të arsimit para universitar,
6. **Janë planifikuar për tu financuar për blerje pajisje laboratorit Fizikë\_Kimi\_Biollogji 30 milion lekë** për afro 40 shkolla/ laboratorë didaktikë në objektet arsimore që përfundojnë punimet në vitin 2018 procedura e prokurimit është realizuar dhe janë furnizuar 40 institucione arsimore me një fond prej 28. 584 mijë lekë
7. MASR është pjesë e Task forcës ndër institucionale në zbatim të VKM nr. 248, date 29.03.2018 për Miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020. Gjithashtu për zbatimin e Miratimit të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.270, datë 17.05.2017 u ngrit task forca institucionale që do të planifikojë zbatimin e planit në praktike. Priten ndërhyrje në kurrikul, në mbështetjen dhe krijimin e infrastrukturës së TIK dhe MASRa të tjera për shtresa në nevojë që mund të jenë fokus i këtij procesi.
8. **Forcimi i nismës "Shkolla qendër komunitare"**. Në vitin shkollor 2015-2016, u zgjerua numri i shkollave duke arritur në 265 shkolla të tilla, nga 66 që ishin në vitin 2013. Numri i shkollave pjesë e kësaj nisme është rritur rreth 4 herë më shumë. MASR në muajin janar 2017 realizoi monitorimin e ecurisë Shkollave si Qendër Komunitare në 265 shkolla dhe u hartua raporti kombëtar për (SHQK).

**Objektiv 3). Realizimi i Maturës Shtetërore 2018**, realizimi i testimit "Mësues për Shqipërinë", në formë elektronikë. Veprimtaritë sipas objektivit 3;

**Zhvillimi i Maturës Shtetërore**, për veprimtarinë e Maturës Shtetërore për rreth 40 mijë maturantë, për dhënien e provimeve të shtetit, si dhe teste kombëtare e ndërkombëtare, janë planifikuar me 140.7 milion lekë, nga të cilat 30 milion lekë në vit mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga shërbimet.

**Në mbyllje të Maturës Shtetërore 2018**, të dy sesionet, u krye analiza e rezultateve të saj. Nëpërmjet "Raportit Publik" të publikuar nga QSHA, u bënë publike të dhënat e Maturës Shtetërore 2018, për institucionet qendrore dhe për publikun e gjerë, të interesuar për këto rezultate.

### 3.1 Administrimi i Maturës Shtetërore 2018

- U hartuan formularët A1 dhe A1Z me udhëzuesit përkatës dhe u dërguan për miratim në MASR.
- U konfigurua sistemi elektronik për realizimin me sukses të procesit të aplikimit të maturantëve dhe kandidatëve, për Maturën Shtetërore 2018.
- U përgatitën materialet dhe u krye trajnimi i specialistëve të DAR/ZA, jo vetëm për procesin e aplikimit, por për gjithë proceset e MSH 2018.
- U testua sistemi për aplikimet e reja në Maturën Shtetërore 2018.
- U monitorua dhe u realizua me sukses, procesi i aplikimit online, në MSH 2018. Brenda afateve të përcaktuara, u bënë rreth 45000 aplikime të reja.
- Për rreth 750 raste të konstatuara, u korrigjuan gabimet e aplikimeve me A1 dhe A1Z, të kryera nëpër shkolla.
- U pasqyruan në sistemin online mbetësit e provimit D3.
- Në bashkëpunim me DAR/ZA-të u pasqyruan në sistemin nxënës të vitit shkollor.
- Në bashkëpunim me DAR/ZA-të u përcaktuan qendrat e provimeve dhe shkollat për çdo qendër provimi. Këto të dhëna u pasqyruan në sistemin për realizimin e proceseve të mëtejshme të MSH.
- U përgatit në kohë e gjithë baza materiale dhe dokumentacioni i nevojshëm, për zhvillimin me sukses të secilit provim të MSH 2018.
- U realizuan me sukses pesë provime, tre të detyruara dhe dy me zgjedhje.
- U pajisen me diplomë të gjithë maturantët e vitit 2018 që kaluan me sukses provimet e MSH, dhe vazhdon ky proces për disa raste të veçanta. Ndërkaq po punohet për përfundimin e procesit të diplomimit edhe për disa raste të prapambetura.
- U pajisen me vërtetime të MSH maturantë ndër vite sipas kërkesave të paraqitura, proces i cili vazhdon gjatë gjithë vitit.
- U përgatit dokumentacioni i nevojshëm dhe sistemi online për provimet e sesionit të dytë të MSH 2018.
- U bënë rreth 400 aplikime të reja në sistemin për provimet në sesionin e II të MSH 2018.
- U prodhuan rreth 40000 barkode, për procesin e sekretimit në sesionin e II të MSH 2018.
- U përgatiten dhe u dërguan në çdo DAR/ZA rezultatet e provimeve të sesionit të II të MSH 2018.

Në mbyllje të Maturës Shtetërore 2018, të dy sesionet, u krye analiza e rezultateve të saj. Nëpërmjet “Raportit Publik” të publikuar nga QSHA, u bënë publike të dhënat e Maturës Shtetërore 2018, për institucionet qendrore dhe për publikun e gjerë, të interesuar për këto rezultate.

| Lënda e Provimit<br>Sesioni i parë | Pjesëmarrës | Kalueshmëria në<br>përqindje | Nota Mesatare<br>në provimin e MSH | Nota Mesatare<br>Vjetore |
|------------------------------------|-------------|------------------------------|------------------------------------|--------------------------|
| <b>Gjuhë Shqipe dhe Letërsi</b>    | 35,687      | 96.78%                       | 6.67                               | 7.13                     |
| <b>Matematikë</b>                  | 35,674      | 94.53%                       | 6.38                               | 6.43                     |
| <b>Gjuhë e Huaj</b>                | 35,682      | 98.79%                       | 7.78                               | 7.19                     |
| <b>Lëndë me Zgjedhje</b>           | 36,433      | 97.00%                       | 6.90                               | 7.64                     |

| Lënda e Provimit<br>Sesioni i parë dhe i dytë | Pjesëmarrës   | Kalueshmëria në<br>përqindje | Nota Mesatare<br>në provimin e MSH | Nota Mesatare<br>Vjetore |
|---|---------------|------------------------------|------------------------------------|--------------------------|
| <b>Gjuhë Shqipe dhe Letërsi</b>               | <b>35,537</b> | 98.62%                       | 6.66                               | 7.01                     |
| <b>Matematikë</b>                             | <b>35,543</b> | 97.79%                       | 6.37                               | 6.4                      |
| <b>Gjuhë e Huaj</b>                           | <b>35,512</b> | 99.58%                       | 7.75                               | 7.16                     |
| <b>Lëndë me Zgjedhje</b>                      | <b>39,763</b> | 96.09%                       | 6.86                               | 7.61                     |
| <b>Të gjitha lëndët</b>                       |               | <b>97.64%</b>                | <b>6.9</b>                         | <b>7.17</b>              |

#### Veprimtaritë e QSHA, (Drejtoria Provimeve të Shtetit) për vitin 2018.

- Zhvillimi dhe administrimi i Provimeve të Shtetit në profesionet e rregulluara të Mjekut, Stomatologut, Farmacistit, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Logopedistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Laboratorit.
- Zhvillimi dhe administrimi i Provimeve të Shtetit në profesionin e rregulluar të Mësuesit në profilet: Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Gjermane, Gjuhë Frënge, Gjuhë Greke, Arsim Fillor, Shkenca Sociale, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Histori Gjeografi, Histori Gjeografi Edukatë, Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë, Kimi Biologji, Edukim Fizik, Arte Figurative, Instrumente Muzikore.
- Zhvillimi dhe administrimi i testimit të informatizuar të mësuesve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit para universitar.
- Përcjellja e rezultateve përfundimtare të provimit të shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara, dërgimi i rezultateve pranë Ministrive, Urdhrave Profesionalë dhe DAR/ZA.
- Përgatitja e Licencave të kandidatëve të suksesshëm në të gjitha profilet e mësuesisë për Sezonin XI Dhjetor 2017-Janar 2018, Sezonin XII Shtator Tetor 2018, si dhe licenca të sezoneve të kaluara. Administrimi i dorëzimit dhe shpërndarjes së tyre drejt DAR-eve përkatëse.
- Përditësimi, riorganizimi, digjitalizimi i fondeve të pyetjeve. Nxjerrja dhe përditësimi në Data Bazë i fondeve të pyetjeve të dërguara për rishikim pranë komisioneve të provimit të shtetit. Përditësimi i fondeve të pyetjeve në server në bazë të procesverbaleve të komisioneve të provimit të shtetit për çdo profesion/profil. Përditësimi i fondeve të pyetjeve në faqen ËEB të QSHA. Digjitalizimi i fondeve të pyetjeve të provimit të informatizuar të mësuesve dhe fondit të pyetjeve të testimit të Gradave të Komisarëve.
- Zhvillimi dhe administrimi i provimit të specializimeve afatgjata në mjekësi dhe provimit të Gradave të Komisarëve

#### Arritjet të detajuara: Statusi i realizimit të aktiviteteve të Drejtorisë së Provimeve të Shtetit është i plotë (100%).

- Zhvillimi provimeve të shtetit në fushën e mjekësisë përgjatë dy sezoneve: Maj 2018 dhe Dhjetor 2018-Janar 2019. Numri i kandidatëve të regjistruar është si më poshtë: Sezoni Maj 2018 kandidatë të regjistruar 1709
- Sezoni Korrik 2018, kandidatë të regjistruar 2238 kandidatë
